

NËN KUJDESIN E  
PAOLO RAGO

**PAQJA E NEVOJSHME**

---

BOTIMET TOENA



Nën kujdesin e  
**PAOLO RAGO**

## PAQJA E NEVOJSHME

MARRËDHËNIET ITALO-SHQIPTARE NË FAZËN  
E PARË TË LUFTËS SË FTOHTË

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Questo libro é stato pubblicato con il contributo del Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale italiano.

Ky libër u publikua me kontributin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Kooperacionit Italian.

Titulli në origjinal: Una pace necessaria. I rapporti italiano-albanesi nella prima fase della Guerra fredda.

Botoi në italisht: Editori Laterzza

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Mirjana Madhi

Përkthim i Diana Çulit për esetë e: Alberto Cutillo, Paolo Rago, Roberto Morozzo della Rocca, Settimio Stallone, Antonio D'Alessandri, Nicola Pedrazzi, Anna Esemplio Tammaro.

ISBN 978-9928-277-69-5

© 2017, Ambasciata d'Italia a Tirana

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## Alberto Cutillo<sup>1</sup>

### Marrëdhëniet midis Italisë dhe Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë

Prej disa vitesh astrofizikanët e të gjithë botës po përjetojnë një situatë paradoksale në disa drejtime. Duke matur shpejtësinë, me të cilën zgjerohet sot universi dhe duke e krahasuar këtë shpejtësi me atë të regjistruar në të shkuarën, kanë arritur në një përfundim sa të padiskutueshëm aq edhe shqetësues: universi që na rrethon është shumë më i dendur nga ai që shohim me sy të lirë. Për të qenë të saktë, universi që ne vëzhgojmë përbën vetëm 5% të universit “të vërtetë”. Po pjesa tjetër? Astrofizikanët mendojnë se 27% përbëhet nga “materia e zezë” ose nga një materie që në shumë drejtime është analoge me materien nga e cila ne përbëhemi: toka, yjet dhe gjithçka që ekziston në universin që njohim, përveç faktit që kjo materie nuk bashkëvepron me 5 përqindëshin e përmendur. Pra, mbetet “e zezë”. Për sa i përket pjesës më të madhe që mungon, 68%, astrofizikanët e kanë pagëzuar “energjinë e zezë”, por, në të vërtetë, askush nuk e ka idenë se çfarë mund të jetë kjo energji e zezë. Dimë vetëm se nuk e shohim dhe se ka një natyrë të ndryshme nga materia që njohim.

I lejoja vetes këtë paralele paksa të guximshme, sepse ky kontekst astrofizik mund të përdoret si metaforë për një tjetër

---

<sup>1</sup> Ambasador i Italisë në Shqipëri.

univers, për atë që përbën objektin e këtij tubimi ose marrëdhëniet midis Italisë dhe Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë. Përqindjet janë të vështira për t'u përcaktuar, por nuk besoj se gabohem shumë, po të them se historianët e sotëm kanë studiuar deri më tani vetëm një pjesëz të vogël (të themi 5%?) të këtij universi. Për një sërë arsyesh, që do të vihen në dukje gjatë punimeve që do të dëgjojmë, në të dyja brigjet e Adriatikut nuk i kemi parë materien dhe energjinë e zezë që përbëjnë një pjesë shumë të madhe të historisë sonë të përbashkët ose, më saktë, si thonë astrofizikanët, nuk i kemi vënë në bashkëveprim.

Gjatë Luftës së Ftohtë Italia hyri në jetën e shqiptarëve përmes radios e më pas përmes televizionit. Por, valët elektromagnetike udhëtonin edhe në drejtimin tjetër të Adriatikut dhe sillnin drejt rajoneve italiane lajme prej këtij vendi misterioz, që asokohe ishte Shqipëria. Në nivel personal, ruaj ende një kujtim të gjallë të Radio Tiranës kur, gjatë pasditeve të pambarimta të verës, në shtëpinë e familjes së nënës sime, në Bazilikatë, e kishim bërë zakon të mblidheshim në orën 19:00 për të dëgjuar buletinin në gjuhën italiane. Emisioni i lajmeve, që paraprihej nga tetë nota marshi, të cilat përsëriteshin në intervale të rregullta për disa minuta, të paktën kështu më ka mbetur në mendje, bazohej në një lexim të shpejtë të lajmeve mbi prodhime të ndryshme bujqësore dhe industriale, të gjitha të karakterizuara nga rritje marramendëse, sinjale të pakundërshtueshme të përparimit të pandalshëm të socializmit real. Duke i dëgjuar, shikonim njëri-tjetrin me dyshim, duke u përpjekur të përfytyronim atë që nuk e tregonin statistikat e ftohta ekonomike: çfarë pamje kishin këta burra e këto gra shqiptare, si visheshin, çfarë ëndërronin, cilat programe shihnin në televizor. Pyetje që do të mbeteshin pa përgjigje edhe për shumë e shumë vite të tjera.

Disa vjet përpara socializmit real në Shqipëri, dy dekadat e diktaturës fashiste në Itali përfunduan në luftë civile. Unë kam lindur shtatëmbëdhjetë vjet pas atij fundi tragjik, por më kujtohet fare mirë se sa e vështirë ishte të përballohej me qetësi një diskutim serioz mbi atë periudhë, të paktën derisa arrita në moshë të rritur.

Besoj se ishte fundi i viteve tetëdhjetë kur, një mëngjes, tek po shkoja në punë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, vura re se kishte mbaruar restaurimi i obeliskut të Foro Italico-s. Pasi ishin hequr skelat, përmbi të lexohej qartësisht mbishkrimi “Mussolini Dux”. Ky mbishkrim, me sa di, kishte qenë atje prej vitit 1932, kur ishte ngritur obelisku, por deri në atë çast shtresat e kohës e kishin fshehur me kujdes. Pasuan javë me debate të ashpra midis atyre që donin të mbulonin përsëri atë mbishkrim e që e shihnin si një apologji ndaj fashizmit dhe të tjerëve që, përkundrazi, mendonin se kishte ardhur ora për t’i mbyllur llogaritë me të shkuarën, dhe relativisht edhe me atë të afërt dhe mjaft shqetësuese në shumë drejtime, meqenëse lidhej me ngjarje ndaj të cilave shumë njerëz ndiejnë ende turp e neveri. Mbishkrimi është atje, i dukshëm, sot e kësaj dite.

Kjo konferencë është fryt i një pune prej më tepër se një viti dhe bën pjesë në një projekt më të gjerë, që do ta shpjegojë më mirë koordinatori i projektit, Paolo Rago. E falënderoj presidentin Moisiu që na nderon me praninë e tij dhe që do të pasurojë punimet e sotme me kujtimet që do të sjellë. Falënderoj, natyrisht, studiuesit e nderuar, shqiptarë dhe italianë, që pranuan të marrin pjesë në këtë studim dhe që sot do të na prijnë në eksplorimin e 95% të asaj toke të panjohur, që ishte para syve tanë dhe që nuk e shihnim: profesor Roberto Morozzo della Rocca-n, i cili, duke trajtuar temën e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, do të na sjellë koordinatat e nevojshme për të kuptuar zhvillimet e mëtejshme, që ndodhën në vend, pas kapitullimit ushtarak italian dhe pas marrjes së pushtetit nga ana e rezistencës komuniste; profesor Settimio Stallone-n, që do të na flasë mbi politikën e jashtme të pasluftës së Italisë në lidhje me Shqipërinë, tashmë një vend jo më objekt i synimeve ekspansioniste, por tërësisht sovran; doktoreshë Enriketa Papa Pandelejmonin, që do të trajtojë kapitullin delikat të riatdhesimit të qytetarëve italianë, civilë dhe ushtarakë, të pranishëm në të gjithë territorin shqiptar

në përfundim të konfliktit; profesor Antonio d'Alessandri-n, që do të na flasë për temën e rëndësishme të rivendosjes së marrëdhënieve tregtare midis dy vendeve, e parë, mes të tjerash, edhe si mjet kryesor për të vazhduar në rrugën e normalizimit të marrëdhënieve politike; këshilltarin Sokol Dedja, që do të na shpalosë evolucionin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Italisë pas shkëputjes së Shqipërisë nga kampi socialist; doktor Artan Hoxhën, që do të analizojë pozicionin e veçantë që mbajti SHBA-ja ndaj Shqipërisë socialiste dhe i negociuar nga pikëvështrimi i Italisë, aleatja e NATO-s, më e interesuara për ruajtjen e stabilitetit në Mesdhe; doktor Nicola Pedrazzi-n, që do të na shpjegojë ndarjet e papajtueshme midis Partisë Komuniste Italiane dhe asaj shqiptare, ndonëse të dyja të karakterizuara nga lufta kundër fashizmit, faktor unifikues për këto dy përvoja, megjithëse edhe shumë të ndryshme; doktoreshë Anna Esemio Tammaro-n, që ka kryer një studim të karakterit juridik mbi dokumente të ruajtura në arkivat britanike dhe italiane e që do të na flasë për rëndësinë e çështjes së arit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë (BNA); dhe, në fund, doktoreshë Nevila Nikën, e cila, duke realizuar një punë të çmuar kërkimore dhe sistemimi të dokumentacionit, i ka bërë një shërbim të gjithë studiuesve që synojnë të punojnë me dosjet e arkivuara në Arkivin Qendror të Shtetit të Republikës së Shqipërisë për sa i përket marrëdhënieve italo-shqiptare nga viti 1944 deri në vitin 1990.

Këto “zbulime”, jam i bindur, do të jenë një kënaqësi e madhe jo vetëm për historianët, por mbi të gjitha për ne, qytetarët dhe institucionet e të dyja vendeve, për t'u njohur edhe më mirë dhe për ta vështruar njëri-tjetrin me ndjenja të një miqësie të rilindur e më të fortë.



**Paolo Rago**

## **Arsyet e këtij studimi historik**

Kjo konferencë ka për qëllimin t'i japë jetë një përpjekjeje të parë për t'u thelluar në çështje me karakter historik, deri më sot pak ose aspak të studiuara, me interes të përbashkët për Italinë dhe për Shqipërinë. Të përfshirë në një fushë të përbashkët, studiuesit italianë dhe shqiptarë, që sot janë mbledhur këtu, iu përgjigjën pozitivisht propozimit për të thelluar studimet mbi marrëdhëniet dypalëshe gjatë viteve të së ashtuquajturës “Luftë e Ftohtë” (1945-1991). Një pengesë e tillë, ndoshta nga më të ndërlikuarat e historisë bashkëkohore, ka shenjuar thellësisht marrëdhëniet e ndërsjella mes dy vendeve tona në dhjetëvjeçarët e dy konteksteve gjeopolitike të papajtueshme që, për herë të parë në histori, morën karakteristika globale.

Kjo konferencë është përfundimi i një faze hulumtimi të kujdesshëm dokumentesh, të kryer në disa institucione arkivore, por jo vetëm në të dyja vendet e interesuara për këtë studim. Synimi i tij kryesor është t'i bëjë të njohur publikut të gjerë, me pasuri argumentesh dhe me një qasje shumëdimensionale, nivelin dhe kompleksitetin e marrëdhënieve dypalëshe, që ekzistonin gjatë periudhës historike të marrë në shqyrtim. Kjo fazë studimore u mbështet me bindjen dhe nxitjen e ambasadës së Italisë në Tiranë, e cila, megjithatë, nuk u përfshi drejtpërdrejt në fazën përgatitore për sa i përket përzgjedhjes së relatorëve, të cilët, më pas, përcaktuan fushat e tyre studimore duke respektuar kushtin e lirisë absolute të kërkimit.

Janë të shumta arsyet që na shtynë të realizojmë këtë projekt. Së pari, po bëhej gjithnjë e më e qartë se nuk mund të shtyhej më tej nevoja për të pasur një pasqyrë më të qartë, ndonëse të pjesshme dhe të paplotë, të ngjarjeve të ndodhura, për të kontribuar për një njohje më të vërtetë të fakteve dhe për një rindërtim më real të ngjarjeve që, nëse do të pranohej nga të dyja palët, do të ishte një arritje shumë pozitive. Së dyti, ndonëse pa e nënvlerësuar angazhimin e ndërmarrë në të shkuarën nga disa studiues, kryesisht italianë, një vështrim i thjeshtë i titujve të botuar gjatë njëzet e pesë viteve të fundit është i mjaftueshëm për të kuptuar se si në të gjithë harkun kohor, që shkon nga 1944-a deri më 1989-ën, numri i veprave të botuara me karakter historik është i kufizuar. Në fakt, përpjekjet e bëra deri më sot nuk japin një kuptim të plotë të kompleksitetit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Republikës Italiane. Sado të duket e çuditshme në shikim të parë, marrëdhëniet dypalëshe të zhvilluara në kushte krejt të papërfytyrueshme, mes problematikash dhe kontradiktash të pamohueshme, pasojë e përvojës fatkeqe të pushtimit ushtarak të Shqipërisë dhe e tragjedisë së mëpasshme të luftës, mundën të përshkonin përsëri rrugën e miqësisë shekullore mes dy popujve fqinjë, por duke zbuluar edhe shtigje të reja, deri më këtë çast krejtësisht të pashkelura.

Duke u nisur nga sa thamë më sipër, që në krye u pa e arsyeshme, që projekti të bazohej vetëm e vetëm mbi shqyrtimin thelbësor të ngjarjeve, duke i lënë dokumentet e studiuara të lira “të flisnin vetë” dhe të interpretoheshin në mënyrë rigoroze. Pa dyshim, ishte një punë e lodhshme të çlironim dokumentacionin e gjurmuar nga mbivendosja e teorive historiografike dhe e kushtëzimeve të natyrës politike, tashmë jo më aktuale ose, për më tepër, të paracaktuara, me qëllim që të hiqnim pengesat me karakter ideologjik e interpretues, të pranishme në të dyja brigjet e Adriatikut në mënyra e në përmasa të ndryshme. Ishim të ndërgjegjshëm se prania e argumentimeve, lidhur në fillim me nacionalizmin e më pas me komunizmin, kanë favorizuar pa dyshim strukturimin e qëndrimeve të paragjykuara, kryesisht -

por jo vetëm - për Ballkanin. Vetëm si shembull do të përmendja ato teori historiografike që prireshin të paraqisnin komunitete etnikisht të pastra, që jetonin të ndara nga njëra-tjetra dhe tërësisht të ftohta ndaj ndikimeve dhe shkëmbimeve kulturore me fqinjët e tyre: të tilla teori sot duken jo vetëm të pakconceptueshme, por, për më tepër, pengesa thelbësore për një njohje të thellë të rajonit dhe të ngjarjeve që e kanë karakterizuar. Gjithashtu, versionet e ndryshme të komunizmit, të zbatuara në vendet ballkanike, me ngarkesën e tyre ideologjike totalitare, kanë ndikuar pa dyshim në formimin e të paktën dy breza historianësh, duke detyruar me forcë modele kulturore të frymëzuara nga arsyeja shtetërore e atyre dekadave. Ky element i fundit ndeshet në të gjitha vendet e rajonit, prandaj është logjike që edhe Shqipëria nuk mbeti e paprekur.

Pa dyshim, për këdo që i njuh çështjet e Europës Lindore, nuk është diçka e panjohur nevoja, shpesh e shprehur në dy dekadat e fundit pak a shumë në mënyrë koherente, edhe për një rishikim të nevojshëm e interpretues të historisë bashkëkohore. Kryetarë shtetesh dhe qeverish të këtyre vendeve, ministra dhe zyrtarë partish, me formim dhe orientim politik të ndryshëm, kanë ndërhyrë, shpeshherë dhe jo rrallë në mënyrë më pasionante sesa racionale, në një debat kulturor që, për vetë natyrën e tij, duhet t'i lihej në dorë "të ngarkuarve me punë", që do të thotë historianëve, studiuesve dhe ekspertëve të kësaj fushe. Për këtë arsye, politika nuk mundet dhe nuk duhet të qëndrojë jashtë përpjekjeve për t'i dhënë jetë rileximit historik: ajo duhet të kryejë detyrën e saj si garante për të gjitha palët e përfshira dhe, pa shumë ndërhyrje, të kufizohet duke siguruar lirinë e kërkimit, duke shmangur imponimin me kushte të shumta, qofshin ato të dukshme apo të nënkuptuara. Duhet thënë me objektivitet dhe pa polemika, por edhe me keqardhje se, edhe disa rezultate të pamohueshme të arritura, janë arritur me shumë vështirësi. Sigurisht, nuk është këtu vendi për të kuptuar arsyet e kësaj vonese. E, megjithatë, ka rënë në sy një mënyrë veprimi e papërshtatshme nga ana e politikës, kur kjo e fundit nuk resht së konsideruari terrenin e studimeve historike si një rezervë gjahu, me synim të përsërisë realitetin

e hidhur të viteve të diktaturës komuniste, të karakterizuar nga presione të vazhdueshme dhe nga ndërhyrje despotike.

Pikërisht me qëllimin për të shpalosur qartazi atë që u theksua sa më sipër, më duket me vend të sjell një dëshmi të gjetur në ish-Arkivin e Partisë së Punës së Republikës Popullore. Nga leximi i tekstit, në disa pika del detyrimi i padiskutueshëm për t'ia nënshtruar studimet historike - atyre që ekzistonin - ideologjisë politike, nëpërmjet ndërhyrjes depërtuese të partisë-shtet, ushtruar me dorën e fortë të numrit dy të hierarkisë më të lartë të atyre viteve.

Nën drejtimin e Mehmet Shehut, kryetari i Këshillit të Ministrave, më 9 mars 1979 zhvillohet një mbledhje në të cilën morën pjesë, mes të tjerëve, Aleks Buda, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Stefanaq Pollo, drejtor i Institutit të Studimeve Historike. Tema është: *Shqyrtim i raporteve "mbi përforcimin e vijës politike proletare të partisë dhe të karakterit kombëtar të studimeve në institucionet e shkencave shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe në arsimin universitar"* dhe *"mbi zgjerimin e riorganizimin e studimeve të historisë bashkëkohore"*<sup>1</sup>. Diskutimi i gjatë, i zhvilluar midis Mehmet Shehut dhe Aleks Budës, mbi të gjitha vë në dukje interesin e klasës drejtuese të kohës rreth studimeve mbi popullatën mitologjike të pellazgëve, temë që vetë Enver Hoxha ua urdhëroi në mënyrë të prerë vite më parë anëtarëve të Akademisë së Shkencave. Rezultatet e shpresuara të studimeve në këtë fushë duhet të kishin dëshmuar pa asnjë pikë dyshimi vazhdimësinë historike të pranisë shqiptare në rajon.

Duke hapur mbledhjen, Shehu i pyet të pranishmit "se si duhet vlerësuar problemi i pellazgëve, paraardhës të ilirëve në tokat e Ballkanit [...], cili është mendimi i historianëve dhe i gjuhëtarëve për problemet e antikitetit"<sup>2</sup>. Ndonëse i kujdesshëm të mos e zhgënjejë kryeministrin, Buda i përgjigjet duke u përpjekur ta sjellë bisedën në një mjedis më shkencor: në të vërtetë, ai shpjegon se si, në mungesë të gjurmës edhe më të

---

<sup>1</sup> AQSH, F. 490, v. 1979, d. 47.

<sup>2</sup> Po aty, f. 2.

vogël që mund të lidhet me ekzistencën historike të pellazgëve, del e nevojshme një punë e përbashkët e specialistëve të sektorëve të ndryshëm (arkeologë dhe gjuhëtarë) dhe shton se një punë e tillë nuk mund të kryhet domosdoshmërisht në një kohë të shkurtër. Por, përpjekja për ta bindur bashkëbiseduesin për pabazueshmërinë e kërkesës nuk sjell përfundim pozitiv dhe argumentet e dhëna vetëm sa e rrisin ngurtësinë e kryeministrit që ngulmon: “Mendoj se detyrë kryesore nuk duhet të jetë zbulimi i lidhjeve që bashkojnë historikisht pellazgët me ilirët, se sa problemi i origjinës së ilirëve. Kjo duhet të jetë detyra e parë e rendit të ditës!”...

Nga sa parashtruar shkurtimisht më sipër, duket qartë se si kërkesat ideologjike të partisë qëndrojnë përmbi çfarëdolloj arsytimi logjik; për më tepër, përballë argumentimeve të paraqitura nga historiani, Shehu duket se ngulmon për të ndjekur vetëm fillin e logjikës së tij<sup>2</sup>, të një natyre tjetër në krahasim me atë më rigorozë të shprehur nga Buda. Dhe, përballë vëzhgimeve dhe dyshimeve të shprehura nga ky i fundit mbi nevojën për të ngritur një veprimtari të kujdesshme gjermimesh, jo vetëm për të mos shkaktuar dëme mbi rrënojat, por edhe për të pasur kohën e nevojshme për të kataloguar me saktësi të pagabueshme materialin e gjetur, Shehu nuk ngurron të përdorë ndaj historianit një gjuhë të pacipë, madje fyese: “Me sa duket, ju po veproni si drejtori i sharrave, i cili ngul këmbë se nuk ka nevojë të presim më shumë dru nga sa është në plan, po edhe ajo që pritet duhet të përdoret, që

---

<sup>1</sup> Po aty, f. 6.

<sup>2</sup> Buda thotë: “Hapet problemi i koordinimit të zbulimit të shtresëzimeve të kulturës antike me shtresëzimet e kulturës gjuhësore, që është problemi më i vështirë për t’u zgjidhur. Dhe unë mendoj se sa më shumë rezultate të kemi në sektorin e gjermimeve arkeologjike prehistorike aq më shumë i afrohem objektivitetit tonë nga këndvështrimet e ndryshme. Kështu, rëndësia e madhe e gjermimeve që u kryen në Maliq, qëndron pikërisht në faktin se atje u verifikua konkretisht shtresëzimi i neolitit të vonë deri në periudhën ilire. Prandaj u përhap ideja e lidhjeve midis pellazgëve dhe ilirëve”.

të mos kalbet nga shiu”<sup>1</sup>. Pastaj, Shehu, me tallje, shton mbarë e prapë këshilla se si duhen ruajtur objektet e zbuluara, duke shfaqur edhe njëfarë arrogance: “Mendoj se duhet t’i ruajmë objektet e zbuluara në mënyrë që të mos dëmtohen as nga shiu e as nga dielli; mund t’i lëmë si nën tokë, ashtu dhe në raftë; sipas llojit të objektit, ndërsa kolonat... mund t’i lëmë dhe në oborr”<sup>2</sup>.

Në të njëjtin dokument ndeshet një tjetër pasazh me interes të madh, ku përsëri Mehmet Shehu po i shpjegon Aleks Budës dhe Stefanaq Pollos interpretimin “e drejtë” të një episodi të historisë bashkëkohore të vendit, revoltën e Shqipërisë së Mesme të viteve 1914-1915, të udhëhequr nga Haxhi Qamili. Duke iu referuar studimeve të kryera mbi ngjarjet e atyre viteve, kryeministri ngulmon se pikësëpari është e domosdoshme të ndërmerret një betejë kundër të ashtuquajturave “shfaqje të huaja”, që do të thotë kundër interpretimeve borgjeze të importuara, ose, akoma dhe më keq, të pranishme në bindjet e disa studiuesve shqiptarë. Shton se një betejë e tillë thelbësore është një aspekt tjetër i luftës së klasave, e cila duhet të veprojë edhe në fushën e shkencave shoqërore. Shehu pohon me bindje:

Për një çështje të tillë, siç dihet [...] deri pa u botuar studimi i shokut Enver [...] në të cilin për herë të parë jepet një interpretim i drejtë marksist-leninist i ngjarjes, shumë historianë nuk kishin këndvështrime aspak të sakta. Përse? Sepse ata nuk shihnin ngjarjet, fenomenet, faktet [...] e lidhura me këtë çështje, nuk i analizonin dhe nuk i interpretonin plotësisht nën prizmin e klasës dhe duke u nisur nga pozita krejtësisht marksiste-leniniste. Vetëm tani, pas studimit të shokut Enver, problemi i revoltës fshatare të Shqipërisë së mesme [...] u bë i qartë për këdo<sup>3</sup>.

---

Këtyre vërejtjeve Shehu i përgjigjet: “Për objektet e gjetura në gërmimet në Maliq, thuhet vetëm se ato i përkasin periudhës para-ilire dhe asgjë më shumë”. Buda i përgjigjet: “Nga analizat e bëra mbi motivet, elementët dhe veçoritë e asaj kulture, del se ka vazhdimësi me një kulturë antike. Megjithatë, ky është një problem që duhet të shihet në tërësi”. Shehu acarohet: “Mund të ketë vazhdimësi para-ilire, por kjo nuk mjafton, sepse duhet ta dimë për çfarëlloj vazhdimësie bëhet fjalë”. AQSH, F. 490, v. 1979, d. 47, f. 6-7.

<sup>1</sup> Po aty, f. 9-10.

<sup>2</sup> Po aty, f. 10.

<sup>3</sup> Po aty f. 33.

Pra, me thëniet e tij, Shehu ofron një recetë të garantuar paanësie dhe objektiviteti për “historianët, gjuhëtarët, studiuesit e folklorit, shkrimtarët, artistët, piktorët, skulptorët, me një fjalë për të gjithë funksionarët e shkencave tona shoqërore [...], që studiojnë pa ndërprerje marksizëm-leninizmin, që nuk largohen kurrë për asnjë minutë nga Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, nga dokumentet e Partisë sonë dhe nga veprat e shokut Enver”<sup>1</sup>. Kështu, një herë e përgjithmonë drejtimet e analizës historike vendoseshin nga partia, ndërsa historianët nuk duhet të bënin gjë tjetër, veçse t’i ndiqnin pa u shkëputur kurrë. Sot duket më e qartë për këdo se një metodologji e tillë, e padiskutueshme dhe dogmatike ka sjellë pashmangshmërisht lindjen e një rryme mendimi, në të cilën viktimat e para ishin vetë liria kërkimore dhe më pas liria e shprehjes.

Për ta përmbyllur këtë parathënie të shkurtër, do të doja të kujtoja sa tronditëse kanë qenë transformimet politike dhe shoqërore të fundshekullit XX, që i rikthyen kësaj pjese të Europës shpresën për t’u bërë plotësisht pjesë e familjes së popujve të kontinentit, rrugë që çdo vend ka nisur ta përshkojë. Personalisht, kujtoj me emocion çastet e para të ndryshimit epokal që ndodhi në Shqipëri kur, duke sfiduar frikën dhe duke ëndërruar me sy hapur, shumë qytetarë thërrisnin nëpër rrugët e Tiranës: “Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa”, duke theksuar me këto fjalë dëshirën e thellë të përkatësisë në historinë kontinentale, të përqaftuar në masë. Megjithatë, duhet të nënvizojmë se mbetet ende shumë për të bërë. Është pikërisht kjo liri, tashmë e fituar në Shqipëri në format e saj më thelbësore, që sot duhet të afirmohet prej atyre që kanë rolin e rëndësishëm të studimit historik, në mënyrë që ta bëjnë një element përbërës të trashëgimisë së

---

<sup>1</sup> Po aty, f. 34. Shehu vazhdon diskutimin e tij duke theksuar: “Studimi i vazhdueshëm i marksizëm-leninizmit, i dokumenteve të Partisë dhe të veprave të shokut Enver është absolutisht i nevojshëm jo vetëm për funksionarët e shkencave shoqërore, të çfarëdo fushe me të cilën merren. Duke u armatosur me mësimet e tyre shkencëtarët tanë, si ata të shkencave shoqërore, si historianët, gjuhëtarët, ekonomistët, shkrimtarët, artistët e kështu me radhë, si ata të shkencave natyrore si biologët, kimistët, fizikanët, matematicienët dhe të tjerë do të jenë në gjendje t’i bëjnë ballë çdo presioni që vjen nga ideologjitë e huaja,

paluajtshme të kombit. Liria e mendimit dhe liria e opinionit janë të vetmet garanci për ndërtimin e një shoqërie realisht të hapur e plurale, ku idetë e secilit të kenë të njëjtin dinjitet dhe ku nuk ka rrezik të mbetesh i papërfillur për shkak të bindjeve të tua. Është e kotë të theksojmë se liria dhe çdo pasojë që rrjedh prej saj, nuk duhet ngatërruar me abuzimin, që është ushtrimi arbitrar i pushtetit, ose me gënjeshtëri.

Jam i ndërgjegjshëm se ky proces nuk do të jetë pa pengesa; megjithatë, ushqej përsëri besimin në krenarinë dhe në ndjenjën e dinjitetit kaq të veçantë të shoqërisë shqiptare për të marrë përsipër një detyrë parësore dhe për ta përmbushur atë. Në ato ditë, tashmë të largëta dhe të jashtëzakonshme, shpirti i ringjallur i lirisë nuk perceptohej me drojë, përkundrazi, pritej me natyrshmëri e spontanitet, sepse falë tij po fillonte të kuptohej më thellë e vërteta e ngjarjeve të trishta që kishin ndodhur deri atëherë në vend. Urimi im është që sot ky shpirt lirie të bëjë të mundur shtrimin e rrugës për një njohje më të vërtetë të ngjarjeve historike, tepër të rëndësishme për marrëdhëniet reciproke, si fryt i studimit të vazhdueshëm të së vërtetës mes kontradiktave të pafundme njerëzore.

*Dëshiroj të falënderoj doktoreshë Stafania Ruggeri-n, doktoreshë Paola Busonero-n dhe doktoreshë Federica Onelli-n për ndihmën që u dhanë autorëve të këtij vëllimi në punën kërkimore që u realizua pranë Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme Italiane.*

---

dhe të tjerë do të jenë në gjendje t'i bëjnë ballë çdo presioni që vjen nga ideologjitë e huaja, se do të dinë të interpretojnë sa më thellë dhe sa më drejt faktet, ngjarjet dhe fenomenet natyrore e në mënyrë të veçantë ato shoqërore që ndodhin në vendin tonë apo kudo në botë, të kuptojnë përse dhe përmbajtjen e tyre politike e ideologjike dhe, nga kjo, të nxjerrin konkluzionet e nevojshme revolucionare”.



## Alfred Moisiu<sup>1</sup>

### Mbi marrëdhëniet shqiptaro-italiane gjatë Luftës së Ftohtë

Pranova me shumë dëshirë të bëja një përshëndetje në këtë Konferencë interesante dhe me shumë domethënie mbi marrëdhëniet midis Italisë dhe Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë, pasi ne jemi dy vende fqinje, të ndara nga një hapësirë ujore prej afro 80 km, por shumë të lidhura historikisht njëra me tjetrën, si për të mirë, ashtu edhe për të keq. Ka shumë rëndësi që ta njohim më mirë të shkuarën tonë, marrëdhëniet midis nesh, që të zhvillojmë një të ardhme më të përsosur midis dy vendeve dhe popujve tanë. Një përmirësim të mëtejshëm edhe më të dukshëm e kërkojnë si interesat midis Shqipërisë dhe Italisë, po ashtu edhe forcimi i mëtejshëm i BE-së, frymës, dhe strukturave të saj. Kjo edhe për faktin e madhësisë së faktorit shqiptar në rajon.

Është e njohur që gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, Shqipëria ishte pjesë e bllokut Lindor, i cili udhëhiqej nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe që bënte pjesë në Traktatin e Varshavës. Pozicioni i saj gjeostrategjik ishte tepër i rëndësishëm si për planet e Traktatit të Varshavës, ashtu edhe për preokupacionin serioz që krijon jo më tepër për NATO-n, por më shumë për vetë Italinë, nëse ky terror do të përdorej për qëllime ushtarake nga blloku agresiv i Lindjes. Megjithëse me zhvillimet e mëvonshme, kur në vitin 1961, Shqipëria u shkëput nga Traktati ushtarak, ky faktor pushoi së qenë rrezik për Perëndimin.

---

<sup>1</sup> President i Republikës së Shqipërisë (2002-2007).

Në atë kohë në Karaburun u përgatitën sheshet për vendosjen e raketave tokë-tokë, të cilat do të synonin goditjen e pozicioneve ushtarake në gadishullin italian. Por raketat nuk arritën të vendoseshin, pasi Shqipëria u shkëput nga Traktati i Varshavës. Dalja e Shqipërisë nga ai traktat nuk ndodhi, sepse udhëheqja e atëhershme shqiptare ishte kundër strategjisë së tyre, por për të shmangur mundësinë e ndryshimeve të brendshme politike, sikurse kishte ndodhur në vendet e tjera të ish-blokut socialist, sikurse quhej ajo pjesë e Europës atë kohë. Në ato vende, përveç Shqipërisë dhe Rumanisë, Hrushovi arriti t'i ndryshonte drejtuesit kryesorë, duke larguar drejtuesit prostalinianë dhe duke vendosur në krye politikanë besnikë të vijës së tij politike. Por tërthorazi vendimi i qeverisë shqiptare të asaj kohe ishte në favor të fqinjëve tanë dhe në tërësi të Europës, pasi rreziku i drejtpërdrejtë u shmang përfundimisht. Kjo sollti më shumë qetësi në shtëpitë e popullit italian, më pak shpenzime mbrojtëse e të tjera. Të mos harrojmë se në Pasha-Liman atëherë ishin dislokuar dymbëdhjetë nëndetëse, që kontrollonin gjithë Mesdheun, dhe me sa më kujtohet në atë kohë marina italiane kishte jo më shumë se tri-katër të tilla, kurse grekët një deri dy. Me largimin e sovjetikëve atje mbetën vetëm katër nëndetëse, të cilat drejtoheshin nga ekuipazhe shqiptare. Por qëllimi i tyre, tashmë i ndryshëm, sepse strategjia e tyre ishte vetëm mbrojtëse dhe nuk paraqiste rrezik për shtetin italian. Aviacioni ushtarak shqiptar dispononte vetëm avionë gjuajtës dhe gjuajtës bombardues, kështu bombardues të mirëfilltë nuk kishte, me përjashtim të një avioni bombardues IL28, që përdorej për qëllime ndihmëse si dhe për stërvitjen e shturmanëve. Por sipas planeve perspektive Traktati i Varshavës parashikohej, që më vonë në aerodromet shqiptare të dislokoreshin deri dy skuadrilje me bombardues. Është e njohur që, kur në vitin 1959 Hrushovi ishte për vizitë zyrtare në Shqipëri, përveç të tjerëve ai shoqërohej edhe nga ministri i Mbrojtjes i BS-së, mareshali Malinovski. Kjo vizitë zgjati më se një javë, që ishte jo shumë e

zakonshme për një kryetar shteti si ai. Krahas qëllimeve politike, ai bashkë me ekspertët ushtarakë po shikonin e studionin, që përveç Pasha-Limanit, në territorin shqiptar të ndërtohej dhe një baze ushtarake tepër e fuqishme në Butrint që do të ishte një rrezik i madh jo vetëm për NATO-n, por në radhë të parë për Gadishullin Apenin.

Pas daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, strategjia politiko-ushtarake e Shqipërisë ndryshoi tërësisht. Ajo përcaktonte që vendi ynë të ishte në gjendje të përballonte, po të qe nevoja, edhe njëherësh Traktatin e Varshavës dhe NATO-n, të ndeshej me ta dhe të dilte fitues. Shpesh ne, në intimitet njëri me tjetrin, nënqeshnim kur e përsëritnim këtë. Por në fakt strategjia ushtarake parashikonte, që lufta te ne të përballej nëse ishte e nevojshme në dy faza; Lufta frontale dhe Lufta Partizane. Për këtë u morën një sërë masash të studiuara me hollësi, duke filluar që nga një fortifikim në gjerësi e thellësi, tepër i kushtueshëm për ekonominë shqiptare, ndërtimi i bazave për depozitimin e municioneve, armatimit, veshmbathjes, ushqimeve dhe gjithçkaje të nevojshme për luftë. Ishte llogaritur që municionet e depozituara të mjaftonin për një vit luftë edhe nëse nuk do të kishte më asnjë furnizim nga jashtë.

E quajta të rëndësishme, që me këtë rast, të sjell disa kujtime që janë karakteristike e këtyre marrëdhënieve të asaj periudhe, por edhe më përpara, pasi sipas meje, historia nuk kuptohet mirë dhe nuk vlerësohet si duhet, nëse ngjarjet shkëputen njëra nga tjetra.

Unë i përkas një brezi që ka përjetuar vitet e fundit të Mbretërisë Shqiptare, pushtimin fashist të Shqipërisë, luftën ndaj nazifashistëve, vitet e para të çlirimit, vitet e diktaturës dhe vitet e demokracisë shqiptare. Rrjedhimisht tregimet e mia janë të dorës së parë, pasi në atë kohë isha pranë organeve drejtuese dhe më vonë bëja pjesë në organet drejtuese të Forcave të Armatosura Shqiptare.

Ne shqiptarët kemi një thënie të vjetër: ***Mikun dhe shokun mund ta zgjedhësh, ndërsa fqinjin ta jep Zoti***, prandaj duhen gjetur

mënyrat për të ndërtuar me fqinjët një miqësi të mirë dhe sa më të qëndrueshme. Historikisht shqiptarët nuk kanë sulmuar ndonjë vend fqinj, por kjo nuk do të thotë se nuk kanë pasur probleme me ta. Me Italinë, përveç situatave të dy luftërave botërore, në vazhdimësi shqiptarët kanë ndier miqësinë dhe mikpritjen e popullit italian dhe këtë e shpjegon më së miri fakti që në Itali sot banojnë dhe punojnë disa breza emigrantësh, ndër më kryesorët janë ata të kohës pas Skënderbeut, të cilët sot njihen në vendin tuaj si Arbëreshët, emigrantët gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe ata pas viteve 90-të. Këta të fundit përbëjnë një masë shumë të madhe, llogaritet të jenë më tepër se 500.000 persona.

Por më duhet të them se jeni për t'u përgëzuar për natyrën dhe shpirtin shumë të gjerë dhe liberal të popullit dhe politikës italiane. Në vitin 2003 kam qenë për vizitë zyrtare në Itali, i ftuar nga presidenti Çampi. Gjatë kësaj kohe m'u dha mundësia të vizitoja disa vise të banuara nga arbëreshët, në Sicili dhe në Kalabri. Nuk mund të harroj, atje takova arbëreshë, të cilët edhe pse më se pesëqind vjet të ikur nga vendi i lindjes flisnin shqip, sigurisht shqipen e asaj kohe, ruanin veshjet kombëtare të kohës, këngët e mërgimit e të mallit dhe rrëfenjat e trashëguara për atdheun e tyre të humbur si dhe traditat e popullit të tyre, përfshi edhe fenë e të parëve të tyre.

Isha në Piana degli Albanesi në Sicili. Atje, përveç takimeve zyrtare, u takova edhe me popullin, vizitova edhe kishën ortodokse të ritit bizantin. E veçoj këtë rast, pasi nga kjo vizitë pata disa përshtypje shumë mbresëlënëse. Në kishë më tërhoqi vëmendjen llambadari i kristaltë i varur në mes të saj, i cili kishte formën e një shqiponje dykrenore, simbol i kombit shqiptar. Kur hyra në ajodhimë, kërkova të shihja librin e shenjtë në çfarë gjuhe ishte. U befasova kur e pashë të shkruar shqip, sigurisht në gjuhën e kohës së tyre. Këto më bënë shumë përshtypje, pasi sot në disa kisha tonat ortodokse mund të mos i gjesësh librat e shenjtë të shkruar në shqip, megjithëse më parë i kemi pasur të tillë, pa folur

për llambadarë apo reliktet e tjera që të kujtojnë vendin. Përshtypje të veçantë më bëri vizita në muzeun etnografik, ku ishin ekspozuar pajisje dhe veshje të të parëve të tyre që nga kohërat e ardhjes në Itali. Falënderova autoritetet që fëmijëve u sigurohej ligjërisht mundësia e mësimi të gjuhës shqipe. Shkurt një trajtim jo vetëm njerëzor, por edhe bashkëkohor sipas normave europiane.

Po kështu edhe trajtimi i emigracionit masiv pas vitit 1990. Tani pjesa e tyre dërmuese jo vetëm janë të punësuar, mijëra prej tyre kanë organizuar biznese konkurruese, por ata janë integruar më së miri, sepse atyre u janë dhënë të gjitha të drejtat që iu takojnë sipas ligjeve të BE-së. Dhe nuk janë pak emigrantë, por mbi 500.000 mijë, afërsisht sa një e gjashta e popullsisë shqiptare. Disa prej tyre, që kanë vendosur të kthehen në atdhe, kanë hapur bizneset e tyre të suksesshme mbështetur në përvojën e fituar gjatë qëndrimit në Itali.

Por kontributi i paorganizuar dhe spontan i Italisë për futjen e një fryme europiane dhe moderne në Shqipëri ka filluar që në kohën e diktaturës. Pikërisht në kulmin e Luftës së Ftohtë. Megjithëse, duke filluar veçanërisht që nga viti 1973, u ndalua shikimi i programeve televizive italiane, njerëzit filluan të bëjnë shpikje të ndryshme për të parë në televizion programet e RAI-t. Atëherë doli në përdorim masiv klandestin e ashtuquajtura *“kanaçe”*, e cila prodhohej në mënyrë artizanale dhe shitej nën dorë. Me anë të saj mundësohej shikimi i televizioneve italiane. Njerëzit ndiqnin në mënyrë të veçantë sportin dhe muzikën italiane, sidomos ndiqej festivali i San Remos. Në këto raste dashamirësit e këtij festivali si dhe të ndeshjeve mblidheshin atje ku kishte televizorë të prodhuar në perëndim, pasi ata ndryshe nga prodhimi i vendit ishin të pajisur me grupin që të mundësonte për të ndjekur drejtpërdrejt emisionet e RAI-t, ose ata që kishin kanaçe shumë të sofistikuar. Kur vinte ora e fillimit të ndeshjeve apo koncerteve, njerëzit fillonin të dilnin nëpër çati ose nëpër pika dominuese për të vendosur antenat. Përveç këtyre shikonin edhe programet e tjera mbi tema të ndryshme, të cilat ndikonin për njohjen e botës perëndimore si dhe për të kuptuar situatat e ndryshme politike.

Italia te ne njihej mirë edhe para Luftës së Dytë Botërore. Njerëzit, sipas mundësive, dërgonin fëmijët për studime në shkollat e larta të Italisë, sepse në Shqipëri në atë kohë nuk kishte universitete. Jo vetëm kaq, por tregtia kryesore e vendit tonë zhvillohej me Italinë. Lëvizja për në Itali ishte shumë më e lehtë sesa u bë më vonë. Më kujtohet kur kryeministri Berlusconi, në vitin 2002, erdhi për vizitë zyrtare në Shqipëri i thashë: *Shkëlqesi pse i keni vështirësuar kaq shumë mundësitë e shqiptarëve për të udhëtuar në Itali. Më kujtohet kur xhaxhai im, që merrej me tregti, shkonte e vinte në vendin tuaj sa herë i duhej, pa ndonjë vështirësi të veçantë, ndërsa sot të marrësh një vizë për te ju është katastrofë. Nuk e kuptoj, ne shkojmë përpara apo mbrapa.* Sigurisht pas kësaj biseda vazhdoi, por ajo nuk ka më rëndësi për ditën e sotme. E solla këtë shembull për të treguar një nga statet e zhvillimit të marrëdhënieve midis dy vendeve.

Gjuha italiane te ne është shumë e përhapur dhe e mësuar kryesisht në mënyrë autodidakte. Gjatë kohës së pushtimit italishtja në shkollat tona ishte e detyruar, krahas gjuhës shqipe. Pas luftës, gjuha italiane gjithashtu u mësua veçanërisht duke ndjekur emisionet televizive italiane. Kryesisht në zonat bregdetare dhe ato të Shqipërisë së mesme. Një herë duke bërë shaka i thashë një ambasadori italian: “Zoti Ambasador, me këtë zhvillim që ka marrë te ne njohja e gjuhës suaj, veçanërisht në zonat bregdetare, duhet bërë kujdes se mos vjen ndonjë kohë dhe do të na thoni se këtu te ne ka minoritete italiane”. Sigurisht kjo ishte një bisedë tepër miqësore, por të dy na bëri të qeshnim.

Duhet thënë se menjëherë pas pushtimit të Shqipërisë në vitin 1939, pati një përmirësim të dukshëm në vend, se në mënyrë të veçantë filluan në masë punimet për përmirësimin e rrjetit rrugor shqiptar në kuadrin e përsosjes së terrenit të artit ushtarak shqiptar, që ishte fillimi i përgatitjeve për agresion në Ballkan. U ndërtuan shumë rrugë të reja dhe u përmirësuan dukshëm

rrugët dhe urat ekzistuese. Filluan punimet për ndërtimin e një filiali të montimit të makinave *Fiat*; por me fillimin e veprimeve luftarake të çetave partizane ato u ndërpreën. U hapën shumë biznese italiane, të cilat mundësuan jo vetëm punësim, por edhe përgatitjen e një klase specialistësh shumë të mirë në të gjithë sektorët e industrisë dhe të mirëmbajtjes së teknikës.

Por me fillimin e rezistencës antifashiste marrëdhëniet midis dy vendeve u vështirësuan shumë. Midis forcave të rezistencës dhe trupave pushtuese pati përplasje me armë, të shoqëruara me viktima nga të dyja palët. Karabinieria, policia dhe milicia fashiste filluan një fushatë reprezaljesh pushtuese, të cilat sigurisht rritën ndjenjat armiqësore. Por menjëherë pas 8 shtatorit të vitit 1943, kur Italia deklaroi daljen nga lufta, ushtarët italianë nga armiq të djeshëm u kthyen menjëherë në miq të shqiptarëve. Është fakt i njohur që ata u pranuan në shtëpitë e fshatarëve shqiptarë, një pjesë e madhe e tyre qëndroi tek ata deri në përfundim të luftës, kurse ata që dëshironin të luftonin kundër nazistëve u inkuadruan në reparte partizane italiane, të krijuara nga vetë ata, me mbështetjen e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL-së, kurse disa të tjerë veçanërisht artiljerë dhe personel mjekësor u inkuadruan së bashku me armatimin dhe pajisjet e duhura në brigadat partizane shqiptare. Për një koordinim sa më të mirë pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL-së u krijua një shtab italian me në krye gjeneral Arnaldo Azzi-n, me një shtab të reduktuar, i cili ishte vendosur në fshatin Alltat, një orë larg Arbanës në një shtëpi fshatare pranë shtabit shqiptar. Më kujtohet si tani se si ishte bashkëpunimi midis anëtarëve të të dyja shtabeve për koordinimin e veprimeve, duke filluar që nga dislokimi i njërive, i veprimeve luftarake, nga shpërndarja e specialistëve, veçanërisht të artilerisë dhe të shëndetësisë në repartet e ndryshme partizane, organizimi i reparteve dhe njërive italiane partizane, sistemimi i atyre ushtarakëve, që nuk dëshironin të luftonin kundër forcave naziste, duke i shpërndarë në fshatrat e

thella malore, në mënyrë që të mos binin në dorën e armikut, në hartimin e programeve të stërvitjes të reparteve dhe njërive partizane si dhe për probleme nga më të ndryshmet. Thashë se më kujtohen këto veprime bashkëpunuese, pasi unë në atë kohë ndodhesha pranë Shtabit të Përgjithshëm Shqiptar, pra këto janë kujtime jo vetëm të një bashkëkohësie, por edhe të një njeriu që ka qenë i pranishëm si dëshmitar okular.

Në fillim u krijua batalioni “Antonio Gramshi”, ndërsa më vonë, me shtimin e kërkesave për të marrë pjesë në luftë, batalioni u transformua në brigadë dhe nga fundi në divizion po me të njëjtin emër. Duhet thënë se ushtarët italianë, të inkuadruar në këtë njësi si dhe ata që ishin të inkuadruar në njësitë e repartet partizane, kanë luftuar me shumë heroizëm dhe trimëri. Gjatë asaj kohe pati edhe dëshmorë të rënë në përpjekje me trupat naziste. Menjëherë pas luftës, me marrëveshje të të dyja qeverive u organizua transportimi i efektivave të divizionit, por edhe të mijëra ushtarëve të tjerë italianë që ishin shpërndarë në fshatrat tona. Me hollësi këtë e ka përshkruar shkrimtari ynë i njohur, Petro Marko, në romanin “Qyteti i fundit”.

Një ngjarje e bujshme ndodhi në 1985-ën, e cila në të ardhmen sollti si pasojë edhe mësymjen e ambasadave të huaja në Tiranë nga një pjesë e madhe të rinjsh dhe qytetarësh shqiptarë, që ishte preludi i ndryshimeve të mëdha në Shqipëri. Ajo është ngjarja e familjes Popa, të cilët familjarisht mundën të depërtojnë dhe të strehohen në Ambasadën Italiane, ku qëndruan deri në vitin 1990.

Por pavarësisht nga situatat, asnjëherë marrëdhëniet midis dy shteteve të atëhershme nuk shkuan deri në atë stad sa të tërhiqeshin ambasadat, pavarësisht nga ulje-ngritja e marrëdhënieve.

Edhe një herë dua të shfaq kënaqësinë time për këtë Konferencë duke ju uruar punime të mbara dhe të suksesshme.

Ju faleminderit për vëmendjen!



*Paqja e nevojshme*

*Marrëdhëniet italo-shqiptare në fazën  
e parë të Luftës së Ftohtë*



## Roberto Morozzo della Rocca

### Pushtimi italian i Shqipërisë

Mbi pushtimin italian të Shqipërisë në vitin 1939 nuk është shkruar pak. Por, do të duhet të thellohemi më shumë në këtë faqe të historisë, për të cilën nuk kemi ende në dispozicion një rindërtim të plotë e bindës. Fakti që në studimet e kohëve të fundit shohim të citohet pa ndërprerje *Albania at War* e Bernd J. Fischer-it dhe rrallëherë me sens kritik, ose dhe zbulime aty-këtu të marra si të besueshme si kujtimet e mëkëmbësit Francesco Jacomoni di San Savino<sup>1</sup> - mbrojtje e vonuar e një veprimi të palavdishëm, thua se ai gjendej në Shqipëri për të vëzhguar *super partes* dhe jo si ekzekutues e planifikues i një agresioni dhe që pas lufte do të përjetonte përvoja të shumta e të hidhura gjyqësore - na shtyjnë të besojmë se ka ende për të gërmuar, për të kuptuar dhe për të mësuar nga njohja e historisë.

Kur, tridhjetë vjet më parë, shkrova librin tim mbi Shqipërinë midis Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, fillova punën, paralelisht me studimin mbi kombin dhe fenë, për të shkruar historinë e pushtimit italian ose të atyre katër vjetëve a më shumë, prej 7 prillit 1939 deri më 8 shtator 1943, bazuar mbi burime të ndryshme: në shkrimet e shumta që botoheshin në Itali në atë periudhë e që flisnin për një Shqipëri të lulëzuar;

---

<sup>1</sup> F. Jacomoni di San Savino, *La politica dell'Italia in Albania nelle memorie del Luogotenente del Re*, Cappelli, Bologna, 1966. Ekuilibri i vështirë mes subjektivitetit dhe objektivitetit, gjithnjë i ndeshur në memuaristikë, shfaqet në rastin e Jakomonit, pa diskutim në favor të subjektivitetit.

në dokumentacionin e arkivave të shtetit italian; në raportet e historiografëve shqiptarë, fatkeqësisht të ndikuar nga drejtimet politike të regjimit enverist; në materiale të arkivave diplomatike të vendeve të ndryshme europiane. Ishin burime që më mundësonin t'afroheshja së vërtetës historike, por ato nuk ishin të gjitha burimet e mundshme dhe të dëshirueshme.

Kur, në vitin 1999 doli libri i Fischer-it, i cituar më sipër, *Albania at War, 1939-1945*<sup>1</sup>, shpresova për një progres të shënuar të studimeve, përmes zgjerimit të burimeve, për shkak edhe të liberalizimit që ndërkohe kishte ndodhur në Shqipëri (studimet e mia ishin deri para rënies së regjimit në vitin 1990). Në vitin 1984 Fischer-i kishte realizuar një studim të dokumentuar mbi Shqipërinë e mbretit Zog<sup>2</sup>, që ishte një përparim i ndjeshëm për njohjen historike, po të kemi parasysh qasjen ideologjike të njëanshme ndaj këtij kapitulli të historisë nga institucionet ekzistuese asokohe në Tiranë. Edhe *Albania at War* bazohet në kërkime të shumta. Megjithatë, Fischer-i nuk përdor burime të arkivave shqiptare, ndërsa referimet ndaj burimeve italiane janë të dobëta e fragmentare. Sigurisht, ka mbledhur gjithçka që ka gjetur në gjuhën angleze nga autorët shqiptarë e italianë, por është e qartë se në të dyja sferat kulturore, që janë të nevojshme për të kuptuar Shqipërinë midis 1939-ës dhe 1943-shit, pikërisht në ato shqiptare dhe italiane, nuk ndihet shumë i sigurt. Fischer-i i merr informacionet e tij nga burime anglo-saksone, që janë kryesisht të dorës së dytë, për sa i përket terrenit që studion<sup>3</sup>.

Zhgënjimi që shkakton libri i Fischer-it rrjedh edhe nga mënyrat e tij interpretuese. Megjithëse pa rënë pre e mendjemadhësisë intelektuale, historiani amerikan gjurmon

---

<sup>1</sup> Purdue University press, West Lafayette, Indiana.

<sup>2</sup> B. J. Fischer, *King Zog and the Struggle for Stability in Albania*, Columbia University Press, New York, 1984.

<sup>3</sup> Një sondazh mbi burimet arkivore italiane ekzistuese, vetëm në qytetin e Romës, për bashkimin e Shqipërisë me Italinë, në periudhën 1939-1945, ka hartuar një listë prej 500 faqesh: shih: E. Trani, *L'Unione fra l'Albania e l'Italia. Censimento delle fonti (1939-1945), conservate negli archivi pubblici e privati di Roma*, Ministero dei Beni Culturali, Romë, 2007.

studimet historike bashkëkohore angleze mbi italianët dhe mbi shoqëritë mesdhetare, për të qenë më të saktë atë të Denis Mack Smith-it, shpesh i cituar nga Fischer-i: një historiografi karikaturiste, fyese, e ngritur mbi *cliché* negative e paragjykuese, ndonëse të lidhura me sfonte makro-politike korrekte. Fischer-i i përdor burimet me një vigjilencë hulumtuese tejet të ulët, aq sa arrin të bjerë në pohime të pamundura, që me pak verifikim dhe me pak shqyrtim kritik do t'ia kishin kursyer. Italianët, në përshkrimin e Fischer-it, janë në thelb absurdë, të korrumpuar, të paafhtë, të paorganizuar, frikacakë, tepër të degraduar e skandalozë.

Me thënë të drejtën, historiani amerikan nuk hesht - të dhënat sasiore të sjella prej tij janë të qarta - si angazhimi i madh i Italisë për ta shndërruar Shqipërinë në kohët e para pas pushtimit me investime të rëndësishme financiare dhe, mbi të gjitha, me ndërtimin e një rrjeti kapilar infrastrukturash, të ngritura me shpejtësi përpara se operacionet ushtarake të detyronin të tjera përparësi. Por, në penën e tij ndihet shtysa për ta bërë qesharake çdo nismë italiane. Ai i quan thjesht “të kota” qindra rrugë të ndërtuara nga italianët, sepse prisheshin menjëherë nga trafiku i makinave, thuajse në to duhet të kalonin vetëm biçikleta dhe karro. Për të qenë të saktë, në rënien e regjimit komunist më 1990, rrjeti rrugor i Shqipërisë ishte ende ai që kishin projektuar dhe ndërtuar italianët. Po japim një shembull tjetër: edhe ndërtesat në stil racionalist fashist, të ndërtuara në Tiranë, prej dekadash trashëgimi kryesore ndërtimore e ndërtesave publike në kryeqytet, i duken gjithashtu “të kota” e madje vetëm fryt i parëndësishëm i manovrave korruptuese të një sekretari intrigant të Musolinit, i cili kishte interesa për mermerin e Karrarës. Mermer i një cilësie kaq të ulët, sa mund të hynte në sasi kaq të mëdha vetëm të shqiptarët primitivë.

Fischer-i shpërthen në gjykime moraliste mbi njerëz e situata, duke i quajtur të besueshme anekdotat, thashethemet, informacionin e rremë, të sajuar nga kushdo agjent diplomatik anglez me shërbim në kryeqytetet europiane. Rrëfimi i tij fiton në ngjyrë e në *gossip*. Kush e njeh mirë Ballkanin e ka të qartë vështirësinë për të dalluar të vërtetën mes zërave të ndryshëm kontradiktorë që qarkullojnë mbi çdo fakt dhe mbi çdo personazh, e di se sa e zorshme është të orientohesh në shtegun

e dizinformacionit, që shpesh rrjedh vetëm nga mashtrimet e skajshme, tipike të këtyre trojeve, të kujtudo që kërkon konfirmim për paragjykimet e tij të rrënjosura dhe të patundura. Është gjithnjë e vështirë të dallosh në Ballkan, se çfarë është propagandë, imagjinatë dhe çfarë realitet. Fischer-i duket se pranon gjithçka që ndesh në burimet e tij, nëse ajo ia gjallëron prozën që shkruan. Kontradiktat janë të pashmangshme.

Për shembull, për Çianon përdor pa masë kujtimet, duke u dhënë besueshmëri si burime serioze dhe autoritare. Kjo mënyrë bie në kontradiktë me portretin skandaloz që Fischer-i ofron në faqet e para për dhëndrin e Musolinit, duke përzier faktet dhe deduktivet: një ministër i Punëve të Jashtme pa përvojë, i papërgjegjshëm, mendjelehtë, i dhënë tej mase pas korrupsionit, më shumë Don Zhuan sesa punëtor, me një prirje të papërmbajtur për t' u rrethuar me spiunë e me intriga, i përqeshur nga diplomatët e huaj, i paaftë të përqendrohet për më shumë se pak minuta, aq vulgar sa Hitlerit i dukej i shpifur, i përçmuar për ekzibicionizmin e tij, për vanitetin, për pacipërinë me të cilën dilte haptazi me dashnoret e që më pas e spiunonin tek agjentët e huaj.

E zëmë se e gjithë kjo është e vërtetë - Çiano ishte një ministër i ri dhe mondan i Ministrisë së Jashtme, vetëm 33-vjeçar, që shprehte një gjallëri rinore e së tepërmi fashiste, që i detyrohej për gjithçka Musolinit, dhëndër i të cilit ishte dhe nën hijen e të cilit jetonte, por vetë fakti se ishte zgjatimi i Duçes, i krijonte mundësinë që të gjitha kontaktet dhe traktativat ku ishte protagonist të dërgoheshin në vëmendje të këtij të fundit dhe kjo pozitë i jepte autoritet, e nxiste të ushqente edhe opinione personale, të cilat përpiquej t'ia përçonte edhe vjehrrit, por që sigurisht, në fund do të ndiqte pa bërë zë vullnetin e tij - dhe është Fischer-i ai që i pari përgënjeshton vetveten, jo vetëm duke iu referuar në pjesë të ndryshme të mëposhtme një Çianoje energjik, aktiv dhe realist, por edhe duke e pasur si pikë kyçe referimi në punimin e tij. Besueshmëria e dobët e burimeve e shpie më pas Fischer-in të anashkalojë ngjarje jo të dorës së dytë.

Sipas meje, rasti më i dukshëm është ai i 7 prillit 1939 ose i operacionit ushtarak të pushtimit të Shqipërisë nga Italia. Fischer-i shkruan për luftime dhe për të vrarë të paverifikuar kurrë, përveçse në fantazinë e ndokujt pa dyshim të interesuar t'i shpikë. E dimë se në ato ditë dolën lajme të rreme në disa gazeta europiane, të frymëzuara politikisht nga antipatia ndaj Italisë fashiste<sup>1</sup>. Sipas Fischer-it, përplasjet e forta e ngadalësuan përparimin e pushtuesve, humbjet italiane arritën deri në 700 vetë dhe ato shqiptare ishin edhe më të mëdha. Shifra e vetëm 12 ushtarëve të humbur nga pala italiane i atribuohet propagandës fashiste. Sot, historiografia e kohëve më të fundit, e dokumentuar mbi këtë episod ushtarak - që është një historiografi edhe antifashiste - ka rindërtuar me hollësi gjithçka që ndodhi dhe konfirmon numrin 12 të të vrarëve italianë gjatë gjithë operacionit, që në disa pikëpamje pati karakterin e një shëtitjeje, por që ishte, megjithatë, një ndër marrje jashtëzakonisht e lehtë, ndoshta jo për meritë të atij që drejtonte pushtimin, por sepse rezistenca shqiptare pothuajse nuk ekzistonte, megjithëse zbarkimi italian ishte paralajmëruar që nga skadimi i ultimatumit ndaj mbretit Zog<sup>2</sup>. E vetmja betejë serioze ndodhi në Durrës, ku kemi pikërisht

---

<sup>1</sup> Në zanafillë të lajmeve të rreme rreth luftimeve të ashpra midis pushtuesve italianë dhe shqiptarëve, të botuara në gazetata e mëdha europiane, ndoshta këtu rishfaqen burimet diplomatike anglo-saksone, të cilave u referohet edhe Fischer-i, është dizinformimi i dhënë nga komunikimet për shtyp të lëshuara nga qeveria e Zogut në çastet e fundit të jetës dhe nga diplomatë shqiptarë që gjendeshin jashtë shtetit në orët e pushtimit. Shih: F. Eichberg, *Il fascio littorio e l'aquila di Skanderbeg, Italia e Albania, 1939-1945*, Apes, Romë 1997, f. 40-41. Shtypi i huaj, veçanërisht ai francez, ngulmonte për të dhënë një "tablo katastrofike të ndërhyrjes italiane, duke theksuar se ushtarakët italianë ishin njerëz me gjakun e mizorive, duke bombarduar e duke djegur qytete e fshatra shqiptare". (M. Borgogni, *Tra continuita e incertezza. Italia e Albania [1914-1939]. La strategia politico-militare dell'Italia in Albania fino all'operazione "Oltre Mare Tirana"*, FrancoAngeli, Milano, f. 371).

<sup>2</sup> Shih: në veçanti Stato Maggiore Esercito, Ufficio Storico, *Le truppe italiane in Albania (anni 1914-1920)*, Romë, 1978; C. Paoletti, *L'operazione "Oltre Mare Tirana"*.

12 të vrarët italianë të 7 prillit 1939<sup>1</sup>. Zogu e kishte organizuar ushtrinë vetëm për të ruajtur rendin e brendshëm, pra pushtetin e tij dhe jo për të luftuar kundër pushtuesve të jashtëm (mes të tjerave ishte stërvitur dhe nga oficerë italianë). Xhandarmëria ishte disi më mirë sesa ushtria, protagoniste e rezistencës së shkurtër në Durrës dhe e ndonjë shkrepjeje pushkësh ndokund tjetër, por edhe ajo e kuptoi se ishte e kotë t'i kundërvihet me forcë një pushtuesi që për momentin dukej i pathyeshëm.

Punimi i Fischer-it duket më i mirë mbi ato aspekte ku ai disponon dokumentacion origjinal, si për shembull për partizanët shqiptarë, për të cilët në Londër ekziston një dokumentacion i rëndësishëm, meqenëse *maqui*-të shqiptarë mbështeteshin nga anglezët që u dërgonin raportet eprorëve (dhe pas lufte disa prej tyre botuan kujtime mbi luftën në Ballkan).

Por, në përgjithësi, punimi i Fischer-it përbën një rast të munguar thellimi në faqe të një historie komplekse, për protagonistët e së cilës kërkohet njohje e mentalitetit dhe e traditave në mënyrë të thelluar, që të mund të lundrohet në burime dhe interpretime të shumta, shpesh jo të vërteta ose pasqyrime subjektivizmash të ndikuara edhe nga pasionet. Shpresojmë që të tjerë studiues, mbi bazën e shumë burimeve që sot për fat të mirë janë të disponueshme, do të përpiqen të rindërtojnë në mënyrë koherente, politike dhe kulturore ngjarjet e Shqipërisë në vitet 1939-1945. Nuk i propozoj përsëri këtu punimet e mia të mëparshme, me kufizimet dokumentuese të lartpërmendura, duke u përqendruar vetëm në disa pika kundërthënëse të pushtimit

---

*“Occupazione dell’Albania nella primavera del 1939, in Storia militare”*, 23 gusht 1995; M. Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani al estero: Albania*, Ministero della Difesa, Commissione per lo studio della resistenza dei militari italiani all’estero dopo l’8 settembre 1943, Romë 1999; Borgogni, *Tra continuità e incertezza, Italia e Albania* cit., f. 310-323. Studimet e historisë ushtarake italiane në periudhën 1939-1945 nuk e trajtojnë me aq shumë hollësi pushtimin e Shqipërisë, sepse, sipas çdo dëshmie, operacioni ishte i pakuptimtë nga pikëpamja e operacioneve të luftës dhe nuk solli humbje të asnjë rëndësie; vetëm se u zbulua përgatitja dhe organizimi i dobët i ekspeditës italiane.

<sup>1</sup> Të rënë italianë gjatë pushtimit u vranë në orët e para të mëngjesit në Durrës; nga dymbëdhjetë të vdekurit, njeri ishte oficer, një tjetër nënoficer dhe dhjetë ishin ushtarë.



italian të vendit të vogël ballkanik, pa pretenduar plotërisht, duke përdorur edhe punime të mëtejshme në kërkimet e mia - punime sektoriale e megjithatë me vlerë metodologjike në një drejtim apo në një tjetër<sup>1</sup>.

Një pikëpyetje e parë. Përse Musolini e pushtoi Shqipërinë e Zogut?

Mund të thuhet fare thjesht se pushtimi i Shqipërisë bënte pjesë në planet imperialiste të Musolinit. Musolini e synonte Ballkanin si një prej drejtimeve të tij kryesore ekspansioniste të Italisë, - të tjerat, siç njihen, lidheshin me pjesë të Francës dhe të perandorisë së saj, me Mesdheun e me territore të Afrikës. Dhe, në Ballkan, Shqipëria ishte vendi më i dobët e më i brishtë, gjë që Italia liberale e kishte kuptuar mirë që në Luftën e Parë Botërore. Pushtimi i Shqipërisë do të krijonte një urë për Italinë në Ballkan, me vetëm 70 kilometra në vijë ajrore nga territori i saj. Me veprimin e 7 prillit, për Italinë u zgjidhën përfundimisht pasiguritë që kishte ndaj politikës shqiptare. Në vitet 1920 dhe 1930 qeveria italiane lëkundej vazhdimisht mes një politike të nderë midis idesë nëse duhet ta bënte Shqipërinë një shtet solid, që të ishte i dobishëm për të penguar grekët e sllavët, të konsideruar konkurrentë dhe armiqtësorë ndaj Italisë, dhe në rast konflikti do

---

<sup>1</sup> Shih: S. Trani, *L'Unione fra l'Italia e l'Albania (1939-1943)*, "Clio", 1, 1994, f. 139-168; Eichberg, *Il fascio littorio e l'aquila di Skanderbeg* cit.; A. V. A. Ercolani, *L'Italia in Albania: la conquista italiana nei documenti albanesi (1939)*, Libera Università San Pio V. Roma, 1999; Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani all'estero* cit.; P. Crociani, *Gli albanesi nelle forze armate italiane (1939-1943)*, Stato Maggiore Esercito, Roma 2001; G. Villari, *L'Albania tra protettorato e occupazione 1935-1945*, tek *L'Italia fascista potenza occupante: lo scacchiere balcanico* "Qualestoria", 1, 2002; D. Rodogno, *Il nuovo ordine mediterraneo. Le politiche di occupazione dell'Italia fascista in Europa (1940-1943)*, Bollati Boringhieri, Torino, 2003; Borgogni, *Tra continuità e incertezza. Italia e Albania* cit.; Trani, *L'Unione fra l'Albania e l'Italia. Censimento delle fonti (1939-1945)* cit.; L. Micheletta, *La resa dei conti. Il Kosovo, l'Italia e la dissoluzione della Jugoslavia (1939-1941)*, Edizioni Nuova Cultura, Romë, 2008; F. Cappellano, D. De Luca, *Le operazioni di contro guerriglia italiana in Albania*, te *L'Albania indipendente e le relazioni italo-albanesi*

të ishte aleat, dhe, nga ana tjetër, të një politike që synonte ta shndërronte Shqipërinë në një protektorat të thjeshtë të Italisë, ose edhe krejtësisht pjesë të integruar të territorit të saj kombëtar<sup>1</sup>.

Zogu kishte ditur të luante me dinakëri mes këtyre dy politikave, duke ia përshtatur sjelljet e tij orientimit të radhës që mbizotëronte në Romë. Në vitin 1938 kryesisht Çianoja dhe më pas Musolini kishin arritur në bindjen se nuk mund të vazhdonin të investonin më pará në Shqipëri, pjesa më e madhe e të cilave shkonte dëm, pa marrë shpërblim, sepse vendi ishte krejtësisht nën kontrollin e plotë të Zogut, dyshues, i zoti, lojtar i dyfishtë, që nuk u garantonte asgjë. Qëndrimi pasiv ndaj impenjimit financiar të Italisë në Shqipëri, i pashpërblyer nga avantazhe politike, ishte shtysë për vendimin që ta pushtonte vendin e vogël në brigjet e përttejme të Adriatikut.

*Ditari* i Çianos është një burim shumë i qartë, herë-herë madje i pacipë, për mendimet dhe vendimet e vetë autorit<sup>2</sup> dhe që është përdorur shumë për ta shpjeguar pushtimin italian të Shqipërisë

---

(1912-2002), nën kujdesin e A. Becherelli-t dhe A. Carteny-s, Edizioni Nuova Cultura, Romë, 2013; E. Aga Rossi, M. T. Giusti, *Una guerra a parte. I militari italiani nei Balcani 1940-1945*, Il Mulino, Bolonjë 2011. Libri i Owen Pearson-it, *Albanian Occupation and War: From Fascism to Communism, 1940-1945*, Centre for Albanian Studies, London 2005, i cili, megjithëse i kushtohet historisë së Shqipërisë, objekti i këtyre faqeve, nuk është një vepër historike, por një kronologji, gjithashtu me kritere tejet subjektive. Vepra, e botuar nga Pearson-i, në moshën 86-vjeçare, ka mjaftpatriotizëm britanik dhe shqiptar të autorit (i riu Pearson në njëfarë mënyre ishte integruar në rrethin e mbretit Zog, që ishte refugjat në Londër). Duket në përzgjedhjen e përmbajtjes, po edhe në përzgjedhjen e burimeve, kryesisht në gjuhën angleze, (ka edhe burime me origjinë italiane, si *Ditari* i Çianos, që janë sjellë në verisonin anglez; në këtë rast të shkurtuara në krahasim me origjinalin) dhe një shprehje e luftës aleate (natyra propagandistike e së cilës trajtohet në librin e Pearson-it me pabesueshmëri sistematike). Nuk kemi përpara një vepër shkencore, por emocione afektive të një të moshuari ndaj një pjesë të jetës së tij, të cilën nuk e harronte dot kurrë.

<sup>1</sup> Shih: P. Quaroni, *Valigia diplomatica*, Garzanti, Milano 1956, dhe A. Roselli, *Italia e Albania: relazioni finanziarie nel ventennio fascista*, Il Mulino, Bolonjë, 1986.

<sup>2</sup> Mbi natyrën e *Ditarit* të Çianos shih: M. Toscano, *Fonti per la storia diplomatica della seconda guerra mondiale*, te *Questioni di storia contemporanea*, nën kujdesin e E. Rota, vëll. I, Marzorati Editore, Milano 1952, f. 531-592.

si pasojë e vullnetit personal të ministrit të Jashtëm italian, që merrte peshë nga marrëdhëniet e tij me Musolinin, të cilat ishin si institucionale, ashtu edhe familjare. Pa dyshim, Çianoja ishte një protagonist i ngjarjes. Sipas Renzo De Felice-s, Çianoja kërkonte në Shqipëri suksesin personal që do ta akreditonte si delfin të Musolinit<sup>1</sup>. Ëndrra e tij për “zotërim të plotë të këtij vendi që do të jetë i yni”, siç shkruante ky ministër i ri i Jashtëm në *Ditarin* e tij, ishte e njohur në rrethet politike të Romës, ku thuhej se Shqipëria do të bëhej Granducato i Toskanës, meqenëse Çianoja ishte me origjinë livorneze. Por, aventura e 7 prillit lidhet me një periudhë më të gjatë.

Rasti e solli Çianon si aktor hiperaktiv, por aneksimet e menjëhershme të kryera nga Gjermania hitleriane (*Anschluss*-i, pushtimi i Sudeteve, copëzimi i Çekosllovakisë) e shtynë Musolinin të realizonte me të shpejtë një sukses ekspansiv për Italinë. Musolini kishte nevojë për një “trofe shqiptar”, për të mos mbetur pas Hitlerit në ekspansionin imperialist dhe, mbi të gjitha, nuk donte që Gjermania ta shtrinte sferën e saj të influencës në Ballkan, ashtu si po e tregonin shumë shenja. Pushtimi i Shqipërisë duhet të ndalte përparimin e Gjermanisë në Europën Juglindore. Si ka vërejtur Giorgio Rochat-i, pushtimi i Shqipërisë përfaqësoje një pushtim territorial që mbushte paaftësinë e depërtimit ekonomik për të cilin Italia nuk i kishte mjetet, ndërsa Gjermania po merrte kontrollin e Ballkanit pa pasur nevojë për aneksimet, por thjesht falë gatishmërisë së saj superiore dhe shfrytëzimit të mirë të burimeve<sup>2</sup>.

Kuptohet, ishte Musolini ai që vendosi pushtimin e Shqipërisë dhe jo Çianoja, që ishte një ekzekutues i vullnetit të vjehrrit, ndonëse përpiqej ta frymëzonte sipas dëshirave të veta. Musolini në këtë ngjarje e mbështeti ambicien dhe interesimin e Çianos për Shqipërinë, por ishte ai që e urdhëroi pushtimin. Regjimi fashist kishte karakter personalist dhe Musolini thoshte fjalën e fundit mbi gjithçka. Vetë Çianoja shkruante një vit më parë: “Në thelb, punojmë vetëm për ta kënaqur; po mundëm, është

---

<sup>1</sup> Shih: R. de Felice, *Musolini il Duce. Lo stato totalitario 1936-1940*, Einaudi, Torino 1981.

<sup>2</sup> G. Rochat, *Le guerre italiane 1935-1943. Dall'impero d'Etiopia alla disfatta*, Einaudi, Torino, 2005, f. 241-242.

kënaqësia më e madhe”<sup>1</sup>. Çianoja deri në fund, pësoi mashtrimet e Musolinit, që më 16 mars shpalli se kishte hequr dorë nga pushtimi i Jugosllavisë dhe se mbështeste pavarësinë e Kroacisë filogjermane kështu, për pasojë, ushtria gjermane mbërriti në kufijtë lindorë italianë, por, më pas, më 23 mars, kur pikasi një dritë jeshile nga ana gjermane, që e linte të paprekur kuadrin e brendshëm jugosllav, autorizoi përsëri pushtimin.

Megjithatë, pushtimi italian i Shqipërisë ishte diçka krejt tjetër nga një veprim i improvizuar, pasojë e rrethanave rastësore. Në të vërtetë, aty kishte një vizion të politikës së jashtme të një periudhe të gjatë, lehtësisht të kuptueshme gjeopolitikisht, e shfaqur që në epokën e Crispi-t, ai vetë me origjinë shqiptare, nga arbëreshët e Sicilisë, i cili e vendoste me kënaqësi në rendin e ditës ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare. Në Luftën e Parë Botërore Italia kërkoi ta bënte Shqipërinë një breg të pestë - njëkohësisht e tuteluar nga austriakët, serbët, bullgarët, grekët - dhe ndoshta do t’ia kishte dalë mbanë sikur më 1920-n turbullirat e dyvjeçarit të kuq<sup>2</sup> të mos e kishin detyruar të tërhiqej nga Vlora, pa u ndeshur më tej me patriotët shqiptarë të rebeluar. Me të drejtë Alberto Basciani vëren, duke reflektuar në mënyrë kritike mbi veprën e Fischer-it:

Duket tepër e kufizuar të paraqitet pushtimi i Shqipërisë, siç vepron Fischer-i, si një aventurë ushtarake kryesisht për të kënaqur ambiciet personale të Çianos dhe dëshirat e Duçes për të treguar forcën. Çështja ishte patjetër shumë më komplekse dhe duhet vendosur në historinë e ndërlikuar të marrëdhënieve italo-shqiptare, të ngjizura gjatë shekullit të njëzetë, po edhe në situatën e veçantë ku u gjend Italia mes viteve 1938 dhe 1939. Pushtimi i Shqipërisë ishte përgjigjja politike dhe ushtarake më e shpejtë që regjimi fashist mund të ofronte për të mbajtur aleatin gjerman, i cili tashmë ushtronte rolin e një fuqie mbizotëruese në rajonin ballkanik dhe në fakt e vendoste Italinë në një pozicion të ndërvarur.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> *Ditari i Çianos*, 10 mars 1938.

<sup>2</sup> Biennio rosso - Me këtë toçfjalësh përmendet zakonisht periudha e historisë së Italisë mes viteve 1919-1920, e mbushur me një numër betejash të punëtorëve dhe të fshatarëve, që kulminuan dhe përfunduan me pushtimin e fabrikave në shtator të vitit 1920 (shën. i përkth.).

<sup>3</sup> A. Basciani, *L'illusione della modernità. Il Sud-est dell'Europa tra le due guerre mondiali*, Rubbetino, Soveria Mannelli 2016, f. 427.

Një pyetje e dytë. Përse Italia u besoi, veçanërisht në fillim, bejlerëve dhe bajraktarëve në administrimin e Shqipërisë së pushtuar? Në të shkuarën, unë vetë kam shkruar:

Me popullsinë shqiptare, përtej deklaratave të forta për bashkimin me Italinë, për afërsinë italo-shqiptare, mbi origjinën e përbashkët romake, mbi erën e re të përparimit të krijuar nga fashizmi, u ndërtua një politikë kompromisesh, për të garantuar qetësinë e shfrytëzimit ekonomik dhe të shndërrimit të Shqipërisë në platformë për ekspansionin ushtarak italian në Ballkan. Të bindur se kishin të bënin me një popull pa aspirata kolektive dhe me një shoqëri të paprekur nga konfliktet shoqërore, që karakterizonin botën perëndimore më të zhvilluar, italianët u përpoqën, që në ditët e para të pushtimit, të gjenin mes shqiptarëve interlokutorë me çmim të lirë, me të cilët të ishte e mundur të kishin dorë të lirë mbi burimet e vendit. I gjetën mes fisnikëve të vjetër, bejlerëve dhe bajraktarëve, më të pandjeshmit ndaj gjithçkaje që ishte arritur e pjekur në Shqipëri nga fitorja e pavarësisë kombëtare e më tej. Kryetari i parë i qeverisë shqiptare nën tutelën italiane ishte pa dyshim Shefqet Vërlaci, pronari më i madh i tokave në Shqipëri, një bej që vetë italianët e shihnin me mosbesim, por që garantonte haptazi pranimin e heshtur të shqiptarëve për programet e Romës në shkëmbim të mosndryshimit *in loco* të klasës drejtuese konservatore tradicionale. Italianët nuk kishin ndër mend të merrnin parasysh nacionalizmin shqiptar, klasën relativisht të gjerë të atyre që, gjatë regjimit të Zogut, kishin mundur të studionin dhe që tani kërkonin një reformë shoqërore rrënjësore, as problemet e frikshme shoqërore të fshatit shqiptar. Problemi ishte të siguronin një administratë me bazë shqiptare, e cila të ndërhynte sa më pak të ishte e mundur në planet afatshkurtra të përdorimit të burimeve në territorin shqiptar.<sup>1</sup>

Ky vizion i imi e mbivlerësonte frymën inovative të mbretërisë së shkurtër të Zogut. Si ka shkruar Marco Dogo, Zogu nuk mundi të ndryshonte shoqërinë shqiptare, përveçse në kufij shumë të ngushtë<sup>2</sup>. Gjatë qeverisjes së tij në veçanti struktura ekonomiko-shoqërore e vendit mbeti e pandryshuar. Reforma agrare ishte

---

<sup>1</sup> R. Morozzo della Rocca, *Nazione e religione in Albania (1920-1944)*, Il Mulino, Bologna, 1990 f. 172-173.

<sup>2</sup> Shih: M. Dogo, *I discutibili privilegi dell'arretratezza: Zog e il caso albanese*, te *L'altra meta del continente; l'Europa centro-orientale della formazione degli Stati nazionali all'integrazione europea*, nën kujdesin e F. Guida-s. CEDAM, Padova, 2003, f. 77-88.

krejtësisht e pavlefshme. Krerët tradicionalë, si bejlerët e Jugut dhe bajraktarët e Veriut, privilegjet feudale dhe tribale të cilëve nuk po i shpjegoj këtu, vazhduan të mbizotëronin shoqërinë. Zogu nuk propozoi alternativë tjetër dhe as nuk mundi të krijonte struktura shtetërore të forta, sepse nuk kishte të ardhura të mjaftueshme nga sistemi fiskal. Formimi i një klase drejtuese të re e më moderne pengohej nga prapambetja e vendit, ku bujqësia përfaqësonte 90% të ekonomisë, ku analfabetizmi ende në vitin 1939 ishte i përhapur në 85% të popullsisë, ku industria dhe klasa punëtore nuk ekzistonin dhe arsimi lëngonte. Zogu duhet të kishte një shtet që të funksiononte dhe një pushtet më pak të kapur nga krerët tradicionalë dhe e dinte se për këtë i duhej kohë. Arsyetoi se si mund të ndizte te shqiptarët një ndjenjë qytetarie. Synoi ideologjinë nacionaliste për të bashkuar një shoqëri anarkiste dhe të ndarë sipas besimit klanor dhe territorial. Në fund të mbretërimit të tij pati dy-tri mijë njerëz me ndërgjegje patriotike dhe me ndjesinë se kombi ishte degraduar intelektualisht, përveçse thellë në brendësi të tij. Pjesa më e përparuar në këtë drejtim ishte ajo e shkollave: mësuesit dhe studentët e liceve të paktë që ekzistonin në vend (nuk kishte asnjë universitet).

Për më tepër Zogu e ndjeu se modernizimi kulturor, i nxitur për t'i dhënë qëndrueshmëri shtetit po i kthehej kundër, për karakterin oriental dhe për korrupsionin që pashmangshmërisht shenjonin veprimtarinë e qeverisë, duke shkaktuar kritikën e *intelligenza*-s në lindje e sipër. Vetë nacionalizmi, që Zogu e nxiste për të modernizuar Shqipërinë dhe për ta afruar me klimën kulturore europiane, po bëhej flamuri i kundërshtarëve të tij. Por, duhet thënë se nuk u krijua një klasë drejtuese alternative ndaj pushtetit tradicional të bejlerëve dhe të bajraktarëve, një prej të cilëve në origjinë ishte dhe vetë Zogu, që tani, i bërë mbret, e ndiente në lëkurën e tij peshën e rëndë të prapambetjes shqiptare.

Blerina Suta ka përshkruar *intelligenza*-n e brishtë shqiptare të viteve tridhjetë, të përçarë nga rivalitete personale, nga kontraste brezash, nga kundërshti politike, nga çështje teorike të thella, nga mungesa e burimeve për të jetuar, nga akuza reciproke

për korrupsion moral dhe material. Nuk ishin këta intelektualë, shpesh edhe të shtrënguar në mërgim ose të kushtëzuar nga mosha tepër e re, ata që mund të ngrinin një alternativë ndaj klasës drejtuese tradicionale<sup>1</sup>.

Italianët trashëguan nga Zogu këtë kontekst politik e shoqëror dhe, edhe ata menduan, veçanërisht në fillim, se nuk mund të qeverisnin pa konsensusin dhe bashkëpunimin e krerëve tradicionalë. Ashtu si kishte vepruar edhe Zogu më 1936-ën, kur krijoi një qeveri nacional-progresiste, atë të Mehdi Frashërit, një nationalist që i drejtohej popullit dhe veproi kështu për të shfaqur qëndrimin antiitalian, po edhe për të treguar aftësitë e tij manovruese, ashtu edhe italianët, në fund të vitit 1941, me prestigj të rënë nga goditja greke, krijuan - duke dashur të joshnin favoret patriotike të intelektualëve dhe të të rinjve, por dhe të shfrytëzonin më mirë krijimin e Shqipërisë së Madhe për të orientuar nacionalizmin shqiptar në favor të Italisë - një qeveri kolaboracionaliste të drejtuar nga Mustafa Kruja, nationalist prej një kohe të gjatë, njëri prej promotorëve të pavarësisë në 1912-ën, që pranohej nga populli<sup>2</sup>. Rezultatet nuk ishin ato të shpresuarat, ndërsa bejlerët dhe bajraktarët, që e urrenin Krujën për origjinën e tij modeste, u zhgënjyen e u larguan edhe më nga pushtuesit, të zhvlerësuar në sytë e tyre edhe nga disfata e fushatës në Greqi. Por, si Frashëri, si Kruja qëndruan në post në kohën e duhur për stratagjemat e taktikat që ata përfaqësonin dhe pas tyre pushteti kaloi në të dyja rastet te bejlerët e bajraktarët

---

<sup>1</sup> Shih: B. Suta, *Intelletuali vs demokracia: il caso albanese (1925-44)*, tek *Intelletuali versus demokracia. I regimi autoritari nell'Europa sud-orientale (1943-1953)*, nën kujdesin e F. Guida-s, Carocci, Romë, 2010, f. 201-215.

<sup>2</sup> Shih: Pearson, *Albania in Occupation and War: From fascism to Communism, 1940-1945*, cit., për referimet antologjike të personazhit; H. Neuwirth, *Qëndresë dhe bashkëpunim në Shqipëri (1939-1944). Një analizë historike e gjedhes kulturore të mikut dhe armikut, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit*, Tiranë, 2006; E. Papa-Pandeljemoni, *Albania during WWII: Mustafa Merlika Kruja's fascist Collaboration*, te *The European legacy: Toward New Paradigms*, DOI: 10.1080/10848770.2014.919192.

(edhe ata nacionalistë, por në një mënyrë tjetër). Si Zogu, edhe italianët mendonin se nuk mund të vareshin pafundësisht nga strukturat e pushtetit tradicional të vendit.

Davide Rodogno theksonte, duke vënë në dukje mbajtjen formale të shtetit shqiptar nën kurorën e Savojës, se synimi i Italisë nuk ishte zhdukja e kombit shqiptar, por që populli shqiptar të bëhej një prej popujve përbërës të “komunitetit perandorak” të Romës, bazuar mbi supremacinë e kombit italian dhe mbi ideologjinë fashiste, ndërsa kombet e tjera, që do të ishin pjesë e tij, si shqiptarët, do të kishin një hapësirë të tyre, por me detyrën për t’u fashistizuar dhe për të marrë nga italianët qytetërimin e tyre superior.

Por, nëse ishte kështu, a nuk bëhej fjalë, në praktikë, për t’i zhveshur nga identiteti kombëtar? Pushtimi i Shqipërisë ishte në fakt një aneksim, meqenëse aktiviteti ekzekutiv dhe legjislativ varej në thelb gjithnjë nga Roma. Dhe krijimi i Partisë Fashiste Shqiptare, identike në strukturë dhe në funksione me PNF-në<sup>1</sup> e gadishullit, a nuk ishte një mënyrë për të asimiluar shqiptarët tek italianët, ndonëse teorikisht do të quheshin popull më vete? Në Shqipëri “u eksportuan, pa kërkuar opinionin e shqiptarëve, strukturat, mënyrat, organizimi, manitë, traditat dhe zakonet e Liktorit”<sup>2</sup> gjë që ishte baraz me italianizimin. Dhe, a nuk synonte asimilimin përhapja e gjuhës italiane, e kulturës italiane, e librave dhe filmave italianë? Synohej, në fakt, të detyrohej një dygjuhësi, që nuk kishte ekzistuar kurrë më parë. Për të mos përmendur se Musolini, Çianoja dhe zyrtarët e tjerë në Romë, që ndiqnin çështjet në Shqipëri, nuk i shmangnin aspak fjalët “aneksim” dhe “përthithje”.

Por, konsensusi politik dhe shoqëror kishte një problem. Pushtuesit italianë binin në kontradiktë. Nga njëra anë nuk donin t’i hapnin syrin grupeve më nacionaliste, që mund të kërkonin një pavarësi të Shqipërisë shumë më thelbësore se ajo simbolike që u ishte lejuar. Nga ana tjetër, ndienin edhe nevojën t’u jepnin kënaqësi shqiptarëve, tek të cilët patriotizmi, apo më saktë etnicizmi, dukej mjaft i rrënjosur për të marrë konsensusin. Këtu

---

<sup>1</sup> PNF - Partito Nazionale Fascista (shën. i përkth.).

<sup>2</sup> Coltrinari, *La resistenza dei militari italiani all'estero* cit., f. 25.



zë fill e ashtuquajtura Shqipëri e Madhe dhe fakti që autoritetet italiane në Ballkan mbështetën shqiptarët në luftërat e tyre nacionaliste me kundërshtarët e tyre historikë: serbët, malazezët, bullgarët, grekët e maqedonët.

Italianët donin të shmangnin që nacionalizmi shqiptar të ngrihej kundër tyre e të kërkonin sovranitetin që 7 prilli i 1939-ës, në të vërtetë, e kishte hequr. Pushtuesit mundën të korruptonin dhe të bindnin me raste ndonjë individ. Por, propaganda, paratë, oferta për poste nuk i ndryshonin bindjet e brendshme. Për këtë arsye dukej me vend të mbështetej nacionalizmi, edhe në nivel popullor, në masën dhe me metodat që mund të drejtohej kundër popujve sllavë dhe helenë. Lëvdohej patriotizmi shqiptar ose, nëse ai drejtohej kundër Italisë, shtypej: ishte, pra një politikë herë shi e herë diell. Kjo strategji e pushtuesve nuk ishte një strategji lineare dhe koherente, por ndoshta nuk ekzistonin as rrugë të tjera.

Nacionalizmi shqiptar ishte i pamposhtshëm dhe, pas tërheqjes së dhimbshme të italianëve përpara grekëve, nuk mund të mendohej më se shqiptarët prireshin ndaj pretendimit të superioritetit italian, që po dëshmohej se nuk ekzistonte. Nëse nuk donin që Shqipëria të ishte armiqësore me ta, duhet të bënin kompromise. Italianët toleruan dhunën dhe pastrimet etnike (apo larje hesapësh) të kryera në Shqipërinë e Madhe nga të mbrojturit e tyre, mbi të cilët kishin gjithnjë e më pak kontroll. Edhe pse Shqipëria e Madhe e kundërshtonte programin afatgjatë për ta bërë shtetin shqiptar pjesë të Italisë, në programin afatshkurtër dëshmonte një garanci të raporteve të mira mes shqiptarëve dhe italianëve (ndonëse pa armët gjermane - dhe këtë shqiptarët e dinin mirë - Shqipëria e Madhe nuk do të mundej të krijohej, e as ndonjë Shqipëri mesatare, meqenëse në fund të vitit 1940 grekët fitimtarë mbi italianët kishin pushtuar një pjesë të jugut).

Pa Shqipërinë e Madhe rezistenca antiitaliane e shqiptarëve do të kishte qenë shumë më e përhapur dhe më e fortë. Më në fund, kërcënimi partizan e zgjidhi dilemën politike të pushtuesve, nëse këta duhej të luftonin kundër nacionalizmit apo t'i lejonin atij hapësirë. Të dyja opsionet u vunë në jetë, por, në nivel strategjik, mbizotëroi kjo e dyta, për oportunitizëm dhe për dobësitë e italianëve. Sigurisht që ata përdorën forcat ushtarake, siç e dëshmon edhe prania në Shqipëri e 100.000 ushtarëve italianë në periudhën e fundit të pushtimit. Dhe ishte lufta kundër partizanëve ajo që provokoi vdekje e dëmtime për popullsinë

civile, që konsiderohej mbështetëse e tyre. Meqenëse ata ishin rebelë të arratisur e të pakapshëm, fshatra të tëra u rrafshuan, u arrestuan familjarë të rebelëve, megjithëse, për hir të së vërtetës duhet thënë se në Shqipëri nuk pati vuajtje, shkatërrime, gjak e mizori si në vendet e tjera të Ballkanit. E megjithatë, nga ana e pushtuesve, mendohej se politika mund të zgjidhte pozitivisht acarimin që po çonte në kryengritje. Kështu, qeveria në Romë, mëkëmbësi, qeveria kolaboracioniste e Tiranës i rivlerësuan aspektet e nacionalizmit shqiptar. Deri në sekondën e fundit italianët armatosën reparte shqiptarësh, pothuajse pa dashur të shihnin se këta largoheshin shumë shpejt, duke u bashkuar me brigadat partizane dhe duke marrë dhe armët me vete. Italianët mendonin, deri para verës së vitit 1942, ta frenonin lëvizjen kryengritëse shqiptare me masa politike, por më pas iu drejtuan profilit ushtarak. Nuk është e rastit vonesa me të cilën lufta kundër partizanëve iu besua reparteve të stërvitjes dhe jo policisë së zakonshme: pushtuesit u gjendën të befasuar përpara një rebelimi krejtësisht të papritur, pasi kishin investuar aq shumë në Shqipëri dhe pasi i kishin besuar lidhjes historike të këtij vendi me Italinë. Siç është vërejtur me të drejtë, italianët nuk ditën të “përpunonin një reaksion unitar dhe koherent që të mos ishte një gërshetim i çrregullt masash shtypëse me lëshime të tjera në drejtim të pavarësisë kombëtare”<sup>1</sup>. Nuk e kishin konceptuar dot rezistencën antiitaliane në një rajon të konsideruar si pjesë faktike e Italisë.

Sigurisht, italianët, të përqendruar në Tiranë, kishin një projekt shndërrimi për Shqipërinë, që në gjysmën e realizimit të tij do të nxirrte jashtë loje bejlerët e bajraktarët për shkak të modernizimit që dukej i pashmangshëm. Por, evolucioni i përfytyruar nga pushtuesit nuk shkoi në drejtimin që dëshironin nacionalistët e përbetuar shqiptarë, të cilët donin të zëvendësonin bejlerët dhe bajraktarët. Është theksuar, në fakt, se italianët nuk parashikonin - pasi të kishin mënjanuar krerët tradicionalë - t'i zëvendësonin me *élites* nacionaliste, por synonin ta asimilonin Shqipërinë në qytetërimin italian, pa dyshim më modern, më i përparuar, shoqërisht më i barabartë sesa ai shqiptar, por edhe i strukturuar nën shenjat e ideologjisë fashiste. Aq më tepër që pushtuesit nuk kuptuan as rrënjët krenare identitare të shqiptarëve, mosbesimin e tyre ndaj të huajve, lidhjen e thellë e të brendshme etnike ndaj traditave, zakoneve, gjuhës dhe kulturës së tyre.

---

<sup>1</sup> Cappellano, De Luca, *Le operazioni di contro guerriglia italiana in Albania*, cit., f. 221.

Më në fund, një pyetje e fundit. Çfarë mendonin vërtet shqiptarët ndaj pushtuesit italian? Ndiënin gjithnjë urrejtje dhe përbuzje, siç ngulmon Fischer-i?

Përvoja ime në vitet e para '90, në takimet me shumë shqiptarë të moshuar, që e flisnin mirë italishten, më tepër më tregonte për kujtime të këndshme rinore në marrëdhëniet me italianët. Edhe për këta njerëz vlente thënia që përdoret mes italianëve dhe grekëve: “stessa faccia stessa razza”. Pasojë e nostalgjisë së rinisë? Apo e 46 vjetëve regjimi të rëndë komunist që e nënvizuan me të kuqe gjithçka që kishte ndodhur më parë? Sidoqoftë, është e pakundërshtueshme se, nga 7 prilli i 1939-ës e deri në tetor të 1940-ës qeveria e Romës investoi mjaft në Shqipëri dhe shumë shqiptarë menduan se me italianët vetëm do të fitonin. U hapën punime publike të konsiderueshme<sup>1</sup>. U ndërjuan rrugë, ura, pallate, ujësjellësa, stadiume, kinema dhe hotele, që nuk ekzistonin më parë. Të rinjtë shqiptarë njohën për herë të parë pushimet në kampet verore. Pagat u rritën shumë herë, u vendosën nivele pagesash minimale, u vendos kujdesi shoqëror e shëndetësor, u zhduk papunësia dhe madje në fshatra filloi të mungojë krahu i punës.

Sigurisht, gjithçka mbizotërohej nga italianët: kompani e shoqëri sipërmarrëse ishin italiane, tregtia me jashtë ishte vetëm me Italinë, burimet natyrore të territorit shfrytëzoheshin për Italinë, e ardhmja ishte të ishte si Italia. Patjetër që kjo nuk u pëlqente shqiptarëve. Megjithatë, ata shihnin të rritej mirëqenia dhe kjo i shtynte të ishin të shoqërueshëm me pushtuesit, të pranonin aktivizimin e tyre realizues. Nga ana tjetër, ishte e vështirë për një shqiptar të përfytyronte t'i kundërvihej fuqisë italiane, aq më tepër që Aksi po dëshmonte në luftën botërore një superioritet të paparë. Një analizë interesante e gjendjes shpirtërore të shqiptarëve në kapërcyell të vitit 1939 mund të lexohet në një raport të dërguar në Londër nga konsullata angleze e Durrësit, se Musolini, pas bashkimit të Shqipërisë me Italinë, nuk kishte ushtruar shtypje, për të mos përkeqësuar marrëdhëniet me qeverinë britanike, duke ruajtur një farë pavarësie të vendit. Dhe bëhet fjalë, vini re, për një burim antiitalian e antifashist:

---

<sup>1</sup> Një përmbledhje sasiore në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Zyra e veprave publike dhe industriale, Shqipëria - *Opere Pubbliche eseguite in Albania dal 1939 al 1944*. III - *Raport i rezervuar*, s. I., s. d. (Romë 1952). Vrulli ndërtesues italian në këtë periudhë është quajtur si një fakt historiografik.

Orientimi i përgjithshëm i popullatës shqiptare mundet ndoshta të kuptohet në mënyrën më të mirë duke vëzhguar disa prej festimeve të shumta që janë organizuar në nder të personaliteteve të ndryshme që kanë vizituar Shqipërinë: Çiano, Starace, Badoglio, de Bono. Teknika e ndjekur në çdo rast të veçantë ka qenë e njëjta, ndryshon vetëm nga intensiteti, sipas famës së çdo vizitori të veçantë. Nga zonat periferike sillen fshatarë, që pranojnë të rrinë në paradë në rrugë. U japin në dorë flamuj, që i tundin ngadalshëm kur para tyre kalon njeriu i madh. Me siguri fshatarët argëtohen nga ajo shfaqje dhe nga skenografia e shkëlqyer, që pa dyshim çmohet më shumë sesa ato të regjimit të kaluar. Ata të klasave më të larta vijnë me uniformë, të cilën ua kanë siguruar organizatat fashiste, i veshin jo aq nga dëshira, por, më tepër, sepse mosmbajtja do të shkaktonte shqetësime të tjera, jo të lehta. Këta njerëz depërtojnë në njëfarë mënyre në shpirtin e manifestimit, por ende nuk kam parë, as te njëri prej tyre, as te ndonjë prej fshatarëve, as edhe shenjën më të vogël të një entuziazmi spontan. Besoj, se në çdo rast, shumica e këtyre njerëzve duhet të ndihen më të sigurt ekonomikisht nën pushtimin italian, sesa kur ishin nën mbretin Zog. Ka punë dhe rrogat janë më të larta e më të sigurta. Natyrisht, nuk mungojnë të pakënaqurit - punonjësit e qeverisë që kanë humbur punën dhe që tani kanë role inferiore, pronarët e tokave që nuk mundin më të përfitojnë të ardhura të pakufizuara - por këta janë një pakicë. Shumica, të paktën në dukje, e ka pranuar regjimin e ri...<sup>1</sup>

Qëndrimi i shqiptarëve do të ndryshojë pas humbjeve të para të italianëve në fushatën kundër Greqisë dhe më tej pas sulmit hitlerian ndaj Bashkimit Sovjetik, që gjallëroi edhe në Shqipëri lëvizjen komuniste. Nga ana tjetër, politika ekonomike e Italisë në Shqipëri do të zbulonte, me kalimin e kohës, një sërë defektesh. Italianët sillnin me shumicë mallra në Shqipëri dhe investonin kapitale, por pasuria përfundonte në pak duar. Disa pasuroheshin pa masë, për shembull përmes sistemit të lejeve të importit, që mëkëmbës Jakomoni ua jepte sipas dëshirës së tij fisnikëve dhe tregtarëve shqiptarë dhe që sillnin fitime mjaft të larta, por qarkullimi i paraparë i mallrave dhe i monedhës nuk e përmirësonte nivelin e jetesës së masave përtej një pragu të caktuar. Nëse rrogat rriteshin, rritej edhe spiralja e inflacionit, e shkaktuar nga qarkullimi i aq shumë parave. Italianët e shumëfishuan numrin e punonjësve të shtetit shqiptar (nga 6.000 në 18.000) ashtu si kishte bërë fashizmi në Itali, për të fituar mbështetje dhe stabilitet

---

<sup>1</sup> *Dispaccio* e 21 nëntorit 1939, në FO, 371/23715 (RI0774/1335/90).

shoqëror, por korrupsioni u përhap në institucionet publike në një masë të paparë kurrë më parë në regjimin zogist. Mund të thuhet se korrupsioni përhapej në proporcion me burimet që qarkullonin në Shqipëri, me vrullin ekonomik, me rritjen e masës monetare, me rritjen e mirëqenies. Por, gjithnjë ishte korrupsion.

Sidoqoftë, lufta pengoi çfarëdolloj planifikimi të italianëve dhe dalëngadalë i vendosi shqiptarët kundër tyre, jo pa e hedhur Shqipërinë në atë që në fund, mes 43-shit dhe 44-ës, ishte një luftë e shkurtër civile. Në vitin 1942 italianët filluan represionin ushtarak ndaj organizimeve të para të rebelëve, pasi për një kohë të gjatë pandehën se mund të përballonin, me operacionet e policisë, vetëm banditizmin dhe u gjendën në një situatë të sikletshme tipike të trupave të rregullta përballë aksioneve të gueriljes. Pa mundur të godisnin drejtpërdrejt partizanët, ushtarakët italianë iu kthyen reprezaljeve të popullatës civile, e akuzuar si mbështetëse. Në një kontekst të tillë, me gjithë përpjekjet në planin politik për t'i qetësuar shqiptarët me koncesione gjithnjë e më të mëdha për nacionalizmin e tyre, mundësitë e italianëve për një mirëkuptim miqësor dhe bashkëpunues u hodhën në erë.

Në përfundim, do të doja të rikujtoja një dokument që me të drejtë është vlerësuar nga Federico Eichberg-u, i cili i referohet qeverisë badoliane gjatë periudhës së të cilës mori fund pushtimi italian i Shqipërisë. Bëhet fjalë për një letër të ministrit të Jashtëm, Raffaele Guariglia-s, të 19 gushtit të vitit 1943, drejtuar gjeneralit Alberto Pariani, i cili prej disa muajsh kishte zëvendësuar Jakomonin si mëkëmbës në Tiranë. Guariglia merrte parasysh dështimin e politikës së fashizmit, për Shqipërinë, i cili e kishte parë Shqipërinë si “trampolinë për ekspansionin italian të Orientit European”. Sipas Guariglia-s, dilte nevoja që Shqipëria të përfaqësonte për Italinë një faktor mbrojtjeje, pra një mbështetëse politike që, duke konsoliduar karakterin e saj të kombit dhe të shtetit, të mund t'i bënte ballë përparimit së Greqisë dhe të sllavëve drejt Adriatikut me synim fatalist antiitalian”.

Dhe shtonte:

Një koncept i tillë vë në dukje qartësisht problemin e pavarësisë së Shqipërisë dhe të forcimit të saj si shtet, tek i cili Italia, logjikisht dhe sinqerisht, do të shihte veçse interesin e saj [...] Interesi italian është që Shqipëria të paraqitet në kuadrin e organizimit european të pasluftës me një entitet etnik dhe politik, vënë në provë që gjatë ngjarjeve dhe vështirësisë të periudhës luftarake, për të mos lejuar që territori i saj të ndahej mes shteteve kufitare, armiqtë e saj tradicionalë...

Sado të mos kishte dashur nacionalizmi shqiptar, - përfundonte Guariglia, - të mbante lidhje institucionale me Italinë, “nga ana jonë duhet gjetur një zgjidhje përmes së cilës të ruhet uniteti politik i vendit”<sup>1</sup>.

Për Guariglia-n, që megjithëse po instruktonte një məkëmbës të ngarkuar me punë në Tiranë, të tutelonte bashkimin dinastik mes Shqipërisë dhe Italisë, ishte më pak e rëndësishme pengesa juridike që mund të lidhte Shqipërinë me Italinë, sesa ekzistenca e një Shqipërie të bashkuar, të fortë dhe sovrane, në gjendje t’i bënte ballë ndikimeve ndërkombëtare armiqësore ndaj Italisë. Italianët komandonin akoma në Tiranë, ishin ende një fuqi pushtuese, por kohët kishin ndryshuar thellë dhe tashmë në Romë pranohej perspektiva e një Shqipërie të pavarur. Ishte një rikthim në politikën tradicionale të Italisë ndaj vendit shqiptar përpara se tymi i imperializmit të depëronte në pallatet e Romës: një politikë mbështetjeje ndaj sovranitetit të saj, për aq sa ishte e mundur në shenjë miqësie.

Letra e Guariglia-s në thelb parashikonte edhe politikën italiane mbi Shqipërinë gjatë Luftës së Ftohtë. Ashtu si e ka përshkruar më vonë Luca Micheletta, pasi Shqipëria mundi të çlirohej nga tutela e regjimit të Titos, Italia doli në favor të sigurisë së fqinjit të vogël adriatikas: “(Italia) kishte filluar të shfaqte, si në dekadat e mëparshme, interesin e saj ndaj qëndrueshmërisë së Shqipërisë. Ushtrarakët italianë, për motive strategjike vazhdonin edhe në vitet pesëdhjetë të mendonin se tani për mbrojtjen e Italisë ishte shumë e rëndësishme, dhe në mënyrë më të përgjithshme edhe për Perëndimin, ruajtja e integritetit dhe e pavarësisë së shtetit shqiptar”<sup>2</sup>. Por, me këto konsiderata dalim si tepër jashtë temës së trajtuar këtu dhe të tjerë do të na thonë nëse vërtet Italia në kohën e Luftës së Ftohtë zgjodhi një politikë dhe një strategji ndërkombëtare filoshqiptare.

---

<sup>1</sup> Guariglia a Pariani, 19 gusht 1943, te *Dokumente diplomatike italiane*, seria IX, vëll. X, nr. 685.

<sup>2</sup> Shih: L. Micheletta, *Diplomacia e democrazia. Il contributo dell'Italia alla transizione dell'Albania verso la libertà*, Rubettino, Soveria Mannelli 2013, f. 17-18.

## Settimo Stallone

### “Kaq e afërt, kaq e largët”

#### *Marrëdhëniet mes Italisë dhe Shqipërisë në vitet e destalinizimit dhe të bashkekzistencës paqësore (1953-1961)*

Vdekja e Stalinit, më 5 mars 1953, megjithëse solli ndryshime të reja dhe komplekse, i çliroi marrëdhëniet italo-shqiptare nga një kushtëzim që deri atëherë kishte penguar normalizimin<sup>1</sup>. U hap një stinë e re, në të cilën të dyja qeveritë ia dolën me mundim të zgjidhnin një pjesë të atyre qëndrimeve kritike, që kishin qenë pengesë e pakapërcyeshme për arritjen e ekuilibrave të rinj e më produktivë mes dy brigjeve të Adriatikut.

Zelli, me të cilin regjimi theksoi përsëri pathyeshmërinë e miqësisë me BRSS-në<sup>2</sup>, synonte të përgënjeshtronte tezat - mjaft të përhapura në disa kancelari perëndimore - që po shqyrtonin mundësinë e një izolimi të ri të Republikës Popullore të Shqipërisë

---

<sup>1</sup> Mbi historinë e marrëdhënieve midis dy vendeve në vitet pas fundit të Luftës së Dytë Botërore, ndërtimi i sistemit ndërkombëtar pasushtarak dhe faza e parë e Luftës së Ftohtë më lejoi të ripropozoja kontributet e mia të mëparshme: *Prove di diplomacia adriatica: Italia e Albania 1944-1949*, Giampilchelli, Torino 2006; *Ritorno a Tirana. La politica estera italiana e l'Albania tra fedeltà atlantica ed "ambizioni" adriatiche (1949-1950)*. Edizioni Nuova Cultura, Romë 2011; *I rapporti italo-albanesi tra Guerra Fredda e ipotesi di normalizzazione. Gli accordi commerciali del 17 dicembre 1954*, te “Processi storici e politiche di pace”, a. VIII, fash. 13-14, 2013, f. 69-100.

<sup>2</sup> Hoxha i kishte shprehur referime dashamirëse Malenkovit që më 21 prill, duke njoftuar ngritjen e përfaqësisë së Moskës në nivelin e ambasadës; ASMAE, SAP 1950-57, b. 655, t. nr. 498/400, Tiranë, 24 gusht 1953.

(RPSH), i detyruar nga një rishikim i ekuilibrave të brendshëm të Kominformit<sup>1</sup>. Shqipëria kishte pasur gjithnjë nevojë për një “mik besnik, ndonëse të largët”<sup>2</sup>, për të baraspeshuar marrëdhëniet e pakënaqshme me vendet fqinje, pasojë e një *moloc*-u - lidhur me përvetësimin ortodoks të direktivave të mëparshme të Kremlinit - që gjithsesi destinohej të shuhej në një kohë të shkurtër, falë sugjerimit që Molotovi i bëri Hoxhës për të përmirësuar marrëdhëniet me Romën, Athinën e mbi të gjitha me Beogradin<sup>3</sup>. Ndonëse “synimet agresive dhe provokacionet” nuk ishin ndalur, marrëdhëniet me Jugosllavinë u rivendosën zyrtarisht më 21 dhjetor<sup>4</sup>. Më pak fat pati përpjekja për të bindur grekët të fillonin bisedime konstruktive për përcaktimin e kufijve<sup>5</sup>.

*Palazzo Chigi* pati vështirësi të bindej për synimet pozitive të shqiptarëve. Të parat *avances*, në pranverë, u pritën me një lloj mosbesimi që u shndërrua në shpresë vetëm nga fundi i verës, kur në Romë - pas lëshimit të vizave për disa prej italianëve të mbajtur - filloi të mendonte se, ndoshta, fjalët me të cilat regjimi shprehej i gatshëm të niste një stinë të re, të bazuar “në një atmosferë shtendosjeje të përgjithshme” mund të pasoheshin edhe nga ndonjë shfaqje gatishmërie konkrete<sup>6</sup>.

Nënkuptimi “jepni provën, se nuk do t’ju qëllojmë” - i papritur dhe në njëfarë mase provokues, krijoi mundësinë që i ngarkuari me punë në Romë, Skënder Konica, t’i bënte të ditur më 17 shtator këshilltarit, Michele Lanza-s, se një anije italiane ftohej të vinte në Durrës - e shtyu *Palazzo Chigi*-n të mendonte

---

<sup>1</sup> NA, FO 371/107287, *Situation in Albania*, përmbledhje, 24 gusht 1953.

<sup>2</sup> Shehu ishte shprehur kështu në mënyrë kuptimplote në Shkodër, pak kilometra larg Jugosllavisë; ASMAE SAP 1950-57, b.656, t. ris. nr. 544/433, Tiranë, 8 shtator 1953.

<sup>3</sup> Për përmbledhjen e bisedimeve shqiptaro-sovjetike të gushtit 1953, shih: AMPJ, F. PPSH, v. 1953. d. 4, k. 3-5.

<sup>4</sup> NA, FO 371/112660, tel. nr. 1001/3/54, Beograd, 30 janar 1954.

<sup>5</sup> AMPJ, F. PPSH, v.1953, dok. nr. 4.

<sup>6</sup> Mes veprimeve që synonin një afrim më të rëndësishëm, duket ndërprerja e dërgesës në legatë - që mundi të rifillonte një vijimësi marrëdhëniesh me autoritetet e regjimit - të notave të protestës rreth fluturimeve të pretenduara të avionëve mbi territorin shqiptar, që prej tre vjetësh po vazhdonin pa zgjidhje; ASMAE, SAP 1950-1957, b. 653, t. ris. nr. 535/427, Tiranë, 3 shtator 1953.



se, si pasojë e “një drejtimi të ri të politikës sovjetike në juglindje të Mesdheut” po ndodhte, më në fund, një ndryshim i direktivave të regjimit ndaj Italisë<sup>1</sup>. Duhej pasur kujdes që Shqipëria të mos i interpretonte “si mbrojtëse apo ndërhyrëse” përsëritjet e deklaratave që kryetari i Këshillit, Giuseppe Pella, i kishte shprehur mareshalit Papagos, me rastin e vizitës së tij të fundit në Romë ose, më saktë, se pavarësia dhe integriteti territorial i Shqipërisë përfaqësonin për politikën e jashtme kombëtare një vlerë jo të negociueshme<sup>2</sup>.

Një evolucion i tillë pozitiv e nxiti *Palazzo Chigi*-n të përmirësonte gjendjen e përfaqësisë në Tiranë, që ishte *de facto* pa një titullar të saj in që nga 19 maji i 1950-ës, kur Omero Formentini u largua nga Shqipëria. U emërua Umberto Lanzetta, i cili nga prilli i vitit 1952 mbante legatën në cilësinë e të ngarkuarit me punë<sup>3</sup>. Edhe caktimi i zëvendësit të Shtyllës la të kuptoheshin sinjale pozitive: ambasadori i ri në Romë, Edip Çuçi, vinte nga një familje borgjeze, e cila në periudhën e Unionit ishte treguar mbështetëse ndaj Italisë<sup>4</sup>.

Ndoshta kishte mbërritur çasti që marrëdhëniet dypalëshe të vendoseshin në një nivel më të lartë. Hoxha nuk ndiqte një “politikë ekskluzivisht shqiptare”: kjo gjë nuk vihej në diskutim. “Kursi i ri” mund të shihej si një përpjekje për të krijuar turbullirë rreth Italisë në kampin perëndimor - lëvizja taktike sovjetike dukej qartazi se synonte neutralizimin e Paktit Ballkanik<sup>5</sup> - po edhe si për të mbështetur idenë - në një valë me “shpersonalizimin” e vendeve satelite, nxitur nga drejtimi i ri kolegjal moskovit (që

---

<sup>1</sup> ASMAE, SAP 1950-57, b. 656, app. i DGAP, Romë, 17 shtator 1953.

<sup>2</sup> *Dichiarazioni di Pella sui colloqui con Papagos*, te “L’Unità”, shtator 1953. Sulle positive reazioni albanesi: ASMAE, SAP 1950-57, b. 653, app. i DGPAP, Romë, 24 tetor 1953.

<sup>3</sup> Ambasadori i ri i paraqiti letrat kredenciale kryetarit të Presidiumit të Asamblesë Popullore, Haxhi Lleshit, më 2 shkurt 1954; ASMAE, DGAP 1941-60 (uff. II ex IV), b. 023, t. nr. 167/107, Tiranë 5 shkurt 1954.

<sup>4</sup> Presidenti i Republikës, Luigi Einaudi, e priti përfaqësuesin e ri shqiptar në Itali më 17 mars; ASMAE, DGAP 1941-60 (uff. II ex. IV), app. i Ceremoniale nr. 5/2096/C, Romë, 17 mars 1954.

<sup>5</sup> Shih: S.Stallone, *In difesa di Enver Hoxha. L’Italia e la questione Albanese di fronte al patto balcanico(1952-1953)*, tek “Eunomia”, a. IV, n. s., fash. 1, 2015, f. 21-46.

kishte përforcuar rolin e Mehmet Shehut<sup>1</sup>) - se regjimi po kalonte një fazë ndryshimesh duke e braktisur pandryshueshmërinë, deri më atëherë me një karakter të veçantë. Ndonëse për diplomacinë italiane synimi final i politikës së jashtme shqiptare mbetet i paqartë, adaptimi i një “qasjeje në vazhdimësi”, për të zgjidhur të paktën disa prej çështjeve të shumta që kishin penguar deri në atë kohë një afrim më të efektshëm, do ta bënte më të lehtë përballimin e ngërçit të vërtetë, që pengonte normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve ose përmbushjen zyrtare të detyrimeve që rridhnin nga Traktati i paqes<sup>2</sup>.

Mund të shfrytëzoheshin gjithashtu, për të përforcuar aftësitë negociatore të Italisë, shqetësimet e regjimit për gjendjen e ekonomisë kombëtare. Objektivat e planit të parë pesëvjeçar, që po shkonte drejt fundit, ishin arritur vetëm pjesërisht dhe shkëmbimet tregtare me vendet e Comecon-it<sup>3</sup> vazhdonin të sillnin rezultate zhgënjyese. Tirana nuk kishte mundur të zëvendësonte partnerin jugosllav: ndërsa me Moskën, më shumë sesa shkëmbime, ato ishin ndihma që ajo i dërgonte falas<sup>4</sup>.

Me këtë rast, në vijim të disa *avances* të shtatorit të kaluar, Shtylla<sup>5</sup> i kërkoi drejtpërdrejt Lanzeta-s, që të nesërmen e mbërritjes së tij në Tiranë, të përpiqeshin për një “ringjallje të shkëmbimeve tregtare”<sup>6</sup>. Sipërmarrjet puljeze po shfaqnin njëfarë interesi, që - bashkë me konsideratat me karakter politik më të

---

<sup>1</sup> Shehu pak më vonë, më 20 korrik 1954, do ta zëvendësonte Hoxhën në detyrën e kryeministrit. Mbi të dhe mbi figura të tjera të historisë shqiptare shih: R. Elsie, *A biographical Dictionary of Albanian History*, I. B. Tauris, Londër-Nju-Jork, 2012.

<sup>2</sup> Duke filluar me lirin e bashkatdhetarëve të dënuar në burgjet shqiptare, me lëshimin e vizës për gratë shqiptare të martuara me italianë, e deri te restaurimi i varrezave të luftës dhe shkëmbimi i motopeshkarexhave të sekuestruara.

<sup>3</sup> COMECON - marrëveshje e nënshkruar në janar të 1946-ës në Moskë mes Bashkimit Sovjetik, Bullgarisë, Çekoslovakisë, Hungarisë, Polonisë dhe Rumanisë, si kundrapeshë me Perëndimin, për “të organizuar një bashkëpunim ekonomik më të gjerë midis vendeve të demokracive popullore dhe BRSS-së”. Pushoi së ekzistuari në vitin 1991 (shën. i përkth.).

<sup>4</sup> Mbi treguesit makro-ekonomikë të ekonomisë shqiptare në fund të planit të parë pesëvjeçar, shih: studimin NATO te: NA, FO 371/117609, Secretariat paper nr. 53, Paris, 7 shkurt 1955.

<sup>5</sup> Pasi u largua nga Roma, Shtylla mori drejtimin e Ministrisë së Jashtme.

<sup>6</sup> AMPJ, drej. IV, v.1954, d.238, dok. nr. 48; ASMAE, DGAP 1941-60 (uff II ex IV), t. nr. 53/44, Tiranë, 30 janar 1954.